



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Votimi nen për nen i projektligjit "Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë".
(Komision për dhënie mendimi)
2. Votimi nen për nen i projektligjit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". (Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Teuta Vodo - Zëvendësministre e Drejtësisë

Artan Lame - Drejtor i Përgjithshëm i ALUZINI-t

Edvin Kukunja - Këshilltar i Ministres së Drejtësisë

Vangelt Duni – përfaqësues i ALUZINI-t

Ermira Gjeçi - Zëvendësministre e Bujqësisë

Majlinda Bozgo - Përgjegjëse në Sekretariatin Teknik në Komisionin Qeveritar të
Tokës/Ministria e Bujqësisë

Lorena Goxhobelli - Këshilltare e Ministrit

Eduard Shalsi – ... për dy projektligjet tani pasdite.

Në pikën 6 të nenit 6, në shkronjën “b”, thuhet: “Përfundimi i proceseve të pajisjes me tituj pronësie të përdoruesve të tokave të ish-kooperative dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët kanë paraqitur kërkesë për këtë qëllim para hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Propozimi i Braçes bie ndesh me këtë ligj, sepse ai thotë që të përjashtohet kategoria e atyre...

Majlinda Bozgo – Më falni, nëse mund t’ju sqaroj!

Është një fashë, janë rreth 1060 familje në Divjakë, të cilat nuk i plotësojnë kriteret me ligjin aktual, por me këtë projektligj këta persona, në fakt, i përmbushin kriteret. Janë një kategori njerëzish, të cilët nuk kanë bërë një kërkesë para hyrjes...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk zgjidhet me nen tjetër...

(Diskutime pa mikrofon)

Ata nuk mund ta dinin se do të kishte një ligj tjetër, i cili do t’ua lehtësonte kriteret, prandaj nuk kanë paraqitur një kërkesë. Pra, me këtë projektligj ata i përmbushin kriteret. Janë 1060 familje, të cilat janë vendosur në Bashkinë e Divjakës, që kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore. Ky ka qenë propozimi i zotit Braçe. Ndërkohë ka edhe banorë, që gjendja civile u është transferuar me vonesë dhe kjo për faj të institucioneve.

Kjo fashë kategorie është menduar të përfshihet, duke qenë se do t’ju lihet mundësia të bëjnë kërkesë, të cilën nuk e kanë paraqitur...

Eduard Shalsi – Kështu siç është formuluar ai pretendon se përjashtohet kategoria që nuk përfshihet....

Majlinda Bozgo – Kjo kategori nuk përfshihet, prandaj kemi bërë sugjerimin se duhet të jetë e hapur, t’u jepet mundësia edhe njerëzve të tjerë...

Eduard Shalsi – E hapur, për sa kohë?

Majlinda Bozgo – Në fakt, unë ju përsërita nenin 12, në të cilin kemi bërë një ndërhyrje dhe kemi thënë: “Njësitë e qeverisjes vendore brenda 6 muajve të evidentojnë përdorues të tjerë faktikë që plotësojnë kriteret sipas këtij ligji”.

Eduard Shalsi – Ndërkohë drejtori ka një propozim, i cili thotë që ta rregullojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është miratuar më parë akti i marrjes së tokës në përdorim...

Majlinda Bozgo – Te cili nen, neni 6?

Eduard Shalsi – Neni 11.

Artan Lame – Po u futëm te neni, do të jetë pak e vështirë të fokusohemi, prandaj të mundohemi ta kuptojmë në parim. Kjo gjë ka qenë shumë e vështirë edhe për ne, sepse ka shumë situata, të cilat kanë ngecur ndër vite, aq sa kërkohet shumë përqendrim që të arrish ta kapësh gjënë. Logjika është e tillë me rastin konkret, atë të zotit Braçe: këto janë grupe familjesh, të cilat gjatë këtyre viteve për një arsye apo për një tjetër, diku e drejtë, diku të padrejtë nuk kanë aplikuar për t'u pajisur me AMTP. Në këto momente, ne në parim me ligjin ishim që nuk duhej të hapej më procesi i riaplikimeve, sepse kjo do të thotë që të ndodhemi para abuzimeve. Pra, sa herë janë shtyrë ligjet, sa herë janë prodhuar situata të tilla, ka pasur abuzime me to. Unë jam i bindur se në qoftë se e hapim shtegun për këta, natyrisht do të ketë lloj-lloj situatash të tjera ku do të ketë edhe përfitime. Në themel këta persona mund të kenë të drejtë, për shkak edhe të nevojës për ta përballuar problemin e Braçes, u munduam të gjejmë një rrugë të mesme. Po e hapëm me ligj, kushdo do të ketë të drejtën për të aplikuar dhe në këtë mënyrë do të abuzohet me aplikimin. Logjika jonë është të bëjmë një VKM dhe aty ta kufizojmë, duke u nisur edhe nga fjala që tha këshilltarja, sidomos për ata persona që nuk kanë aplikuar në kohë për shkak të ndërrimit të gjendjes civile. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që duke e bërë me VKM, fokusohemi vetëm te zona e Braçes, duke ju kërkuar dokumentacionin nëse ka qenë apo nuk ka qenë personi, ndërsa po e hapëm për gjithë Shqipërinë...

(Diskutime pa mikrofon)

Në parim unë kam qenë kundër kësaj gjëje dhe jam kundër hapjes prapë të aplikimeve, sepse nuk do të mbarojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të aplikojë për ta marrë! Jam për ta zgjidhur problemin e tyre, por pa hapur aplikimin në të gjithë Shqipërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe këtu ka dhe nuk ka të drejtë, sepse po të nisemi nga e drejta ky njeri që në 25 vjet nuk ka ardhur të trokasë një herë në shtet, të aplikojë për të marrë letrat, nuk ka se çfarë kërkon pas çerek shekulli. Nuk është në rregull, sepse nuk ka aplikuar. Prandaj, të thashë të mos hyjmë tek arsyet pse nuk ka aplikuar deri sot, sepse ka arsye të ligjshme dhe të paligjshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Prandaj unë nuk jam për ta zgjidhur me nen, por me VKM.

Domethënë iniciatori i ndryshimit është Braçe, nga ana tjetër pranohet edhe nga Ministria e Bujqësisë që ekziston si fenomen, pranohet edhe nga bashkitë që ekziston si fenomen. Pra, ka përdorues faktik të tokës pa asnjë lloj dokumenti.

Tani kam shumë pyetje. Një nga pyetjet që i bëra kolegut është se ky është një fenomen që ekziston në Bashkinë e Divjakës? Apo edhe në të gjitha bashkitë e Shqipërisë? Sa raste të tilla kemi? Si kanë lindur këto raste? Pse nuk kanë aplikuar? Në çfarë rrethanash kanë qenë? Disa nuk legjitimoheshin nga ligji, sepse kishin ndryshuar gjendjen civile për shkak se donin të përfitonin ndihmën ekonomike në qytet, disa të tjerë kanë emigruar 20 vjet para.

Vullnet Sinaj – Pra, mos janë nga ata njerëz të cilët kanë përfituar tokë në territorin e një kooperative tjetër?

A është normale që ai të përjashtohet?

Atyre nuk ke pse t'iu japësh, sepse kanë marrë tokë në veri, kanë ardhur në Divjakë, sepse iu është zaptuar toka e vjetër nga liqeni i Fierzës.

Majlinda Bozgo – Këta janë një grup njerëzish, të cilët kanë qenë punonjës të NB-së, unë i kam thirrur në zyrë dhe i kam dëgjuar, kanë qenë banorë, kanë qenë me familje në atë fshat, më 01.08.1991, kjo është data që merret nga ligji, kanë qenë banorë faktikisht, punonjës të NB-ve, pra nga ana tjetër kanë qenë subjekte të ligjit, por gjendja civile iu është transferuar me vonesë dhe sot me ligjin aktual këta persona nuk plotësohen me titull pronësie, sepse çedojnë në një nga kriteret kryesore të ligjit që është vendbanimi më 01.08.1991. Nëse iu kërkon sot certifikatën e gjendjes civile, e shikon se ata nuk kanë qenë banorë në datën 01.08.1991, por mund të kenë ardhur nga rrethet e tjera. Pra sot nuk mund të plotësohen me AMTP. Propozimi i zotit Braçe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Toka iu është dhënë, e punojnë.

Eduard Shalsi – Kjo është tjetër gjë, ky nuk ka marrë certifikatën e pronësisë.

Majlinda Bozgo – Nuk e di nëse ka qenë në Divjakë, por ndërmarrje bujqësore ka qenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Nuk ka certifikatë ai, por duhet të marrë...

(Diskutime pa mikrofon)

Majlinda Bozgo - Flasim gjithmonë për tokë bujqësore.

Eduard Shalsi – Është kategori tjetër ajo.

(Diskutime pa mikrofon)

Një sekondë!

Kush po fliste tani?

Majlinda Bozgo –Kjo është situata. Ata kanë qenë banorë dhe faktikisht e plotësojnë kriterin e të qenit subjekt i ligjit, por gjendja civile u është transferuar pas datës 01.08.1991, çka e bën të pamundur plotësimin sipas kuadrit të ri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Kam një shqetësim...

(Deputeti Ilir Beqaj flet pa mikrofon)

Atje ku ishin...*(nuk dëgjohet)* mos kanë marrë edhe atje?

Majlinda Bozgo – Ky patjetër që duhet të jetë kriter përjashtues dhe kusht. Nuk duhet të marrim...

(Deputeti Ilir Beqaj flet pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Të gjitha premiset, Beqaj... U tha 1060. Unë shifrën e parë e kam dëgjuar mbi 1500. Shifrën tjetër e dëgjova 600, tani është 1060. Sinqerisht, kam pikëpyetje për përmasat.

Nga ana tjetër, nëse do të ekzistonte si fenomen, nuk do të doja të ndodhte vetëm në Divjakë, për shkak të një deputeti, i cili duhet admiruar për të qenit luftarak, por në qoftë se duam t'i japim zgjidhje fenomenit, e para duhet të shohim...

Unë kam një propozim dhe një kompromis: ta lëmë me VKM, siç propozon drejtori, por pasi për një periudhë 3-mujore apo 6-mujore të merret një bazë e saktë se sa janë të tilla nga çdo bashki.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – VKM-ja del në zbatim të ligjit. Nëse në ligj e lëmë të shprehur në këtë formë, që nuk lejohet, pra kusht për t'u plotësuar me AMTP-në do të jetë kërkesa, VKM-ja nuk mund të dalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – E thamë. Ne duam me ligj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, Berti!

Ne do ta hapim shtegun me një nen që do ta përcaktojë VKM-ja, por duam ta lidhim VKM-në, që, në rast se të dhënat nga bashkitë nuk janë të sakta, të mbajnë përgjegjësi për letrën që do të niset te agjencia dhe kjo e fundit të mos ndërmarrë asnjë veprim. Edhe nëse do ta bëjmë VKM-në (po prezumojmë se e hapëm shtegun, bëme edhe VKM-në), kur të fillojnë të dalin nesër ato 1060 familje, jam i bindur se do të dalin gjëra që nuk kanë lidhje me këto ndryshime që do të bëjmë ne.

Majlinda Bozgo - Në fakt, fenomeni nuk është i kufizuar vetëm në Divjakë, por është në të gjithë Shqipërinë. Bëhet fjalë për më shumë se 1060 familje. Është Divjaka...

Eduard Shalsi – Atëherë, kjo është një arsye më shumë që VKM-ja të dalë mbasi të gjitha bashkitë, me përgjegjësi të plotë, të sjellin rastet tipike. Dhe e dinë pastaj... Nëse nuk është 1000, është 10 mijë, 5000, 6000... Me këtë kufizojmë edhe çdo lloj dalldie që mund të bëhet, sepse realisht është e drejtë ajo që thuhet, që mund të bëhet shkak për abuzim.

Po, Beqaj.

(Deputeti Ilir Beqaj flet pa mikrofon)

Ilir Beqaj -...bazike.

A ka ndonjë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë?

Kam një shqetësim. E kam shumë empirike këtë që do të them, por ka disa përcaktime në Kodin Civil apo ku ta di unë, që po e përdore një gjë për x vite të lind e drejta gjithmonë. Le të thotë çfarë të dojë ky ligji këtu, vjen një avokat dhe me një nga këto parimet kushtetuese e merr...

Që ne të bëjmë kufizime, ndoshta duhet të shohim pak se çfarë ndodh me atë tjetrën. Ju e dini...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, gjyqësisht, por ama...

Kam një merak tjetër, kryetar. Është e vërtetë që këto punë lidhen shumë me bashkitë, por duhet ta pranojmë se në vitin kur ky ligj fillon, bashkitë deri nga mesi i marsit e kanë kokën te puna, pastaj fillon fushatën. Pa dashje të mos e konvertojmë këtë proces, që është shumë i rëndësishëm, me një gjë që do të ndodhe atje. Bashkitë, po të ishin të përgjegjshme, do ta kishin bërë me kohë këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vitin tjetër ato vetvetiu janë në një siklet, sepse mund të ndërrohet këshilli dhe kryetari. Për mendimin tim, që nga prilli deri në gusht nuk shoh ndonjë mundësi për t'u marrë me këto punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me 30 qershor janë zgjedhjet, pastaj, sa të dalë rezultati, sa të konsolidohet këshilli i parë, sa të betohet kryetari i bashkisë e të tjera...

Eduard Shalsi – Çështja është a do ta fusim në rrugën e zgjidhjes, apo do ta lëmë pa e targetuar këtë grup problematik. Unë them se do ta fusim në rrugën e zgjidhjes nëse bashkia është efiçiente apo efiçase.

Pra, kemi një ligj, të cilit me një nen t'i hapim shtegun për ta bërë. Por nuk jam dakord që ne të lëmë shtegun dhe në janar apo në shkurt të dalë VKM-ja pa pasur ende një pamje të qartë se sa do të afektohet, sepse këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Divjakën, por për të gjitha kategoritë. Sa është e përfshirë, këtë nuk di ta them. Unë kam pikëpyetje nëse Divjaka paska 1060.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Në momentin që është bërë privatizimi, ishin punonjësit e fermës apo kooperativave bujqësore që u takonte të merrnin tokë. Atëherë ishte ligji, sipas të cilit njerëzit duhet të merrnin përkrahjen sociale ose tokën. Por të dyja bashkë nuk i merrnin dot.

Eduard Shalsi – Po, pra.

Majlinda Bozgo – Në momentin që njerëzit merrnin asistencën, atyre nuk u takonte toka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fillim, kur filloi privatizimi, kush donte tokën, e mori atë dhe kush donte të ikte, mori asistencën. Në momentin që merrnin asistencën, atyre nuk u takonte toka. Toka pastaj u shpërnda në bazë të frymëve që kishte në shtëpi, si në Divjakë, Lushnjë dhe kudo që ishin.

Nuk e di se çfarë rasti është ky.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse janë nëpër zyrat ku kanë qenë tek asistenca.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po si nuk janë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - Në përgjithësi, duke u nisur edhe nga ajo që tha zoti Beqaj, meqenëse u futëm direkt te trajtimi, do të doja që për një moment të dalim jashtë ose të ngrihemi lart gjësë, si hapje...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, logjika është e tillë, ne me këtë ligj duhet të mbyllim procese të zvarritura. Në qoftë se ne rihapim prapë afate aplikimi, po të isha dikush tjetër nga ky që jam, do t'ju thosha më mirë të hapen se i krijoj vetes shteg për të bërë lloj-lloj qokash, sidomos po u hap shtegu i riaplikimit të qytetarëve. Po u hap kjo gjë, nuk do të hapet vetëm për Divjakën, por për gjithë Shqipërinë. Në përgjithësi fryma e ligjit është për të mbyllur procese të hapura dhe jo për të rihapur procese që i ka mbyllur koha. Ne e dimë që toka për ato 438 mijë familje që kanë marrë AMDP dhe në gjithë malin e madh të AMDP-ve të drejta janë ato që janë dhënë nga viti 2000, ndërsa pas këtij viti përgjithësisht është abuzuar, është ndarë bregu dhe të gjitha këto historitë e tjera. Kush kish për të marrë tokë e mori vitet e para, ndërsa ne po e rihapim prapë këtë çështje në 2018-ën për t'u dhënë mundësi edhe disa të tjerëve. Megjithatë, unë e ndiej ndjeshmërinë dhe për njëmijë arsye duhet ta zgjidhim...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë në parim isha kundër kësaj gjëje...

Eduard Shalsi – Kjo gjë varet se cilin ka pasur përballë, mund të ketë pasur deputet të rinj si puna jote dhe nuk e ka bërë të ndjeshme, ndërsa tani me kontekstin e ri...

(Diskutime pa mikrofon)

Mund të jesh i hekurt me dikë, ndërsa me një tjetër mund të jesh i ndjeshëm dhe nuk arrin ta kuptosh diferencën.

Artan Lame – Pra, ajo që jam duke ju thënë është fakti të mos e hapim për gjithë Shqipërinë, sepse në qoftë se bëjmë këtë nuk e di se çfarë do të ndodhë, megjithatë nuk e vendos unë këtë gjë...

(Diskutime pa mikrofon)

Të hapim shtegun te një nen i veçantë dhe të përcaktojmë kur qeveria rasti pas rasti gjendet në situata të veçanta që nuk janë marrë parasysh dhe nxjerr një VKM për këto raste dhe përmes saj ne përcaktojmë disa kriteret për rastin konkret, ku të themi: “Për rastet kur nuk kanë aplikuar e të tjera...”, pra t'i përcaktojmë te VKM-ja.

Ky është shqetësimi im për këtë gjë, të cilin dua ta zgjidh, por jo nëpërmjet ligjit. Realisht jam duke ju thënë se nuk dua ta marr atë kompetencë, sepse kjo kompetencë është shumë luks, për të hapur afatin dhe të futet...

(Diskutime pa mikrofon)

Zotit Beqaj, me sa shoh iu mbush mendja.

Eduard Shalsi – Majlinda dhe Lorena, a keni ndonjë merak?

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Në qoftë se ne biem dakord që të bëhet me VKM, mënyra se si është krijuar ky nen nuk krijon fare hapësirë për VKM. Jam dakord të bëhet jo vetëm për Divjakën, sepse jam e sigurt që në gjithë Shqipërinë ka, prandaj duhet lënë hapësirë dhe të zgjidhet për të gjithë.

Ermira Gjeçi – Për këtë arsye ne e rishikuam, meqenëse ky fenomen është ngado, nuk është vetëm në Divjakë. Për këtë arsye kemi vënë dy kushte dhe kemi thënë: “Të jetë subjekt përfituesi i ligjit”. Pra, me ligjin nr. 7501, datë 01.08.1991 ai përfitonte. Fakti i dytë, përdorues faktik i tokës bujqësore. Kjo do të thotë se ai person është përdorues, nuk është emigranti, i cili është larguar apo dikush tjetër që vjen nga qyteti...

(Diskutime pa mikrofon)

I gjithë ligji në vetvete është se unë do të regjistroj faktin. Atëherë, kur ne themi nga fillimi në fund për çdo pronë që do të regjistrojë faktin, atëherë kur bëhet verifikimi i të tërës do të bëhet edhe verifikimi i kësaj...

(Diskutime pa mikrofon)

Robert Bitri – Fakti si dokument...

Ermira Gjeçi - Ne kemi dy informacione...

Eduard Shalsi – Pyetja e Bertit është e drejtë, sepse na është thënë që ky fakt ekziston, pa dokument.

Ermira Gjeçi – Ne kemi dy informacione, gjithmonë për tokën bujqësore. 50 000 raste në fillim të 2018-ës kanë qenë pa marrë aktin e marrjes së tokës në pronësi, që do të thotë që nuk kanë asnjë lloj dokumenti. Pra, këto 50 000 raste e kanë në përdorim tokën, sepse Komisioni i Ndarjes së tokës ua ka dhënë, por nuk është finalizuar. Formulari 6, është një formular që nuk gjendet në të gjitha DAMD-të, plus që nuk është dokument ligjor, prandaj nuk e gjejnë...

Robert Bitri – Vetëm atje ku janë ndarë tokat. Atje ku është ndarë toka, formulari 6 është prezent.

Ermira Gjeçi – Nga 50 000 rastet sot kemi: kërkesa të paraqitura nëpër bashki 11 648, të plotësuara janë 5491 dhe në total kërkesa të plotësuara janë 8240. Çfarë pretendojmë? Pretendojmë që një pjesë, afërsisht 20 000 nuk kanë paraqitur kërkesat, pavarësisht se ne i kemi shtyrë bashkitë t'i identifikojnë të gjithë fermerët për të plotësuar një kërkesë pranë tyre për t'u pajisur me AMDP? Këtu futet zona e Veriut, si dhe rastet ku në fshatra të tërë komisionet nuk kanë vepruar, prandaj bashkitë menjëherë duhet të nisin procesin e plotësimit.

Pra, kemi thënë që nuk ndajmë tokë nga e para, pasi toka është ndarë, komisionet e kanë ndarë tokën, por themi të pajisen me dokument.

Eduard Shalsi – Të biem dakord për një formulim, nuk e di ku ekzaktësisht, që t'i hapim shtegun nëpërmjet një VKM-je. Ndërkohë, unë personalisht, sepse ju e dini vetë, agjencia do të jetë përgjegjëse për këtë punë, kompetencat nga ministria do t'i kalojnë agjencisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Në çfarë viti?

2003-2004, në rregull. Kjo ishte për të korrigjuar deklaratën, në rregull?

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, të biem dakord për një formulim për hapjen e shtegut dhe më pas lënia e VKM-së.

Zoti Lame, do të doja që VKM-ja të mos dilte pa pasur një gjë të saktë mbi bazën e së cilës do të kalkulohet VKM-ja.

Pra, informacioni që do të shërbente si bazë për ndërtimin e VKM-së, sepse VKM-ja do të jetë e qartë te rezultati i saj, por nuk do të jetë në qoftë se...

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo që ju sapo thatë është e rëndësishme, por nga ana tjetër është një target grup, të cilin nuk mund ta lëmë jashtë vëmendjes. Ne japim shtegun, nëse bëhet në janar, shkurt apo në mars...

Eglantina Gjermani – Nga përvoja hartohet VKM-ja dhe u vihen kushte bashkive, sepse ta bëjnë bashkitë dhe më pas të adresohet, mendoj se kjo gjë do të zgjidhet sipas kriterëve që do të vendosen në VKM. Më pas bashkitë le të vrapojnë dhe ta bëjnë...

Eduard Shalsi – Unë them këtë, nëse ti nuk di se çfarë baze të dhënash ke dhe se çfarë numri problematikash do të zgjidhësh, atëherë VKM-në do ta bësh mangët. Pra, nëse ti nuk do të më japësh mua analizat që unë të përcaktoj se si do të kuroj, kjo është pika që këmbëngul...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne sot jemi duke folur paradoksalisht për diçka së cilës nuk ia dimë përmasën...

(Diskutime pa mikrofon)

A jeni të qartë për pjesën juridike si do të zgjidhet kjo? Jeni dakord që do të jetë me VKM? Në rregull.

Çfarë keni nevojë të diskutojmë tjetër?

Lorena Goxhobelli – Sa i takon “Subjekteve të ligjit”.

(Diskutime pa mikrofon)

Te proceset tranzitore. Në nenin 7 përcaktohet që akti i marrjes së tokës në pronësi fituar para hyrjes në fuqi të ligjit konsiderohet i vlefshëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet, pra përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen.

Në germën “a” thuhet: “Subjekti ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore dhe/edhe nëse nuk ka qenë legjitimituar ka përfituar tokë për të cilën i është hequr pronësia atij apo trashëgimlënësit”.

Sugjerimi që ka bërë Ministria e Bujqësisë është që të kufizohet vlefshmëria ligjore e AMDP-së vetëm për subjektet e ligjit sipas legjislacionit të kohës dhe të mos zgjerohet te subjekte të tjera, të cilat nuk legjitimohet, por mund të kenë përfituar tokë së cilës i është hequr pronësia. Pra, kjo kategori...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj fjalën!

Nuk jam duke folur për bashkëthemeluesit, sepse është tjetër kategori. Kjo është e hapur për të gjithë ata që mund të kenë marrë një AMDP në abuzim të ligjeve të kohës, sepse nuk kanë qenë subjekte të ligjit, pra janë përfshirë në këtë ligj edhe ish-pronarët. Ish-pronarët janë subjekt i një ligji tjetër dhe jo i këtij ligji...

Eduard Shalsi – Lorena, shumë e qartë!

Cili është koncepti që qëndron mbrapa këtij neni?

Artan Lame – Logjika e gjësë është e tillë, sepse nuk duhet të harrojmë shtresëzimin në kohë të gjërave. Këta kanë një titull pronësie që është ADMP-ja, e cila mund të jetë dhënë në kundërshtim me ligjin.

Eduard Shalsi – Abuzive...

Artan Lame – Pra, ai ka tokën, por ka edhe AMDP-në. Tani t'u themi pas 27 vjetësh që AMDP-ja që ke marrë ti është e paligjshme kur unë vetë si shtet ua kam dhënë, sepse automatikisht ai futet në proces gjyqësor, pasi ka tokën dhe AMDP-në, është jo produktive, sepse do të na fusë në një mori gjyqesh pa fund.

Nga ana tjetër, nga pikëpamja formale juridike, për sa kohë ai ka marrë një titull pronësie nuk mundemi t'ia heqim sot. Ky është parimi i gjësë, ku ne themi se nuk duhet të merremi me atë që e ka marrë, pra e njohim faktin nëse i takon apo nuk i takon nëse ka një titull. Përveç kësaj, pasi kjo ka ndodhur me kategori që duhej të aplikonin te kthimi i pronave për këtë gjë. Zakonisht ky problem më shumë është për zonat e Veriut, të cilët nuk e kanë marrë mundimin të aplikojnë tek Agjencia e Kthimit të Pronave, por kanë shkuar me logjikën që kjo është toka e gjyshit dhe janë pajisur me AMDP. Sot është e kotë që ne t'u themi se do t'ua heqim këtë, prandaj shkoni e na hidhni në gjyq, duke hapur kështu me mijëra gjyqe, si dhe shkoni e aplikoni tek Agjencia e Kthimit të Pronave, sepse ai nuk përfiton asgjë, madje ai nuk e di se ku bie Agjencia e Kthimit të Pronave. Megjithatë, edhe po të shkojë, ai sot me legjislacionin e sotëm të kthimit të pronave nuk ka për të aplikuar dot, sepse janë 1000 arsye që nuk aplikon dot.

Ne mendojmë të mos hapim fronte betejash të kota dhe pa sens kur ata janë stabilizuar dhe e kanë gjetur me njëri-tjetrin zgjidhjen.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermira Gjeçi – Këta janë ish-pronarët, sepse ligji me këtë lloj parashikimi e hap në tërësi edhe ndaj atyre personave që kanë përfutur tokë si ish-pronarë. Pra, si ish-pronarë, nuk e kuptoj se mbi çfarë dokumentacionesh, se ata nuk legjitimoheshin për ta marrë këtë tokë. Kjo gjë nuk ka të bëjë me rastin e Veriut, sepse për këtë rast futen ata persona që nuk kanë asnjë lloj dokumenti, as AMDP dhe asnjë dokument tjetër që të provojë pronësinë, janë thjesht posedues të një toke, të cilën pretendojnë se e ka pasur stërgjyshi i tyre.

(Diskutime pa mikrofon)

E kanë gjetur paqen.

Lorena Goxhobelli – Janë trajtuar në projektligj, por nuk është rast specifik çështja e Veriut për t'i dhënë zgjidhje...

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Po të shkosh në Malësinë e Madhe, është një vend që ndahet me një përrua që quhet Guri i Madh, ku vetëm 1 herë në 5 vjet bëhet not. Distanca është 15 metra dhe ti je i çmendur për ta zbatuar një për një, si në Afrikë, Ekuador, por ama ata...

Lorena Goxhobelli – Ata do të përfitojnë, pasi me projektligjin e ri është parashikuar se ata do të pajisen me dokumente...

Artan Lame – Ne u themi hiqni këto letra që keni se do t'ju japim disa letra të tjera, nuk ka sens të hyjmë në situata që kanë përfituar dhe kanë gjetur rregullim...

Lorena Goxhobelli – Bashkëthemeluesit kanë përfituar dhe këta konsiderohen pjesë e ligjit, është te fjalja e parë: “Subjekti që ka qenë legjitimuar”. Ne jemi duke folur për një kategori tjetër, të cilët mund të jenë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e di se nga dalin...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, jam duke folur për ata që kanë një titull pronësie, që kanë një AMTP, aktin e marrjes së tokës në pronësi.

(Diskutime pa mikrofon)

Ajo është kategori tjetër, për jam duke folur për ata që kanë titull pronësie, prandaj drejtori ka të drejtë për këtë pikë...

(Diskutime pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Ne e kundërshtojmë këtë...

Eduard Shalsi – Ministria e Bujqësisë e kundërshton këtë çështje, ndërsa ALUIZNI e mbron...

(Diskutime pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli - Nuk ka asnjë lloj kriteri se si është hequr pronësia, me çfarë dokumentacioni e mbështesin. Ligji nr. 7501 thotë shprehimisht se pronësia para hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk njihej...

Vangelt Duni – Dispozita është hartuar, duke u nisur nga fakti se, në bazë të akteve të themelimit të kooperativave bujqësore në rastin e shpërbërjes së tyre pronarët që kishin

kontribuar me tokë në kooperativë do të merrnin mbrapsht tokën që kishin futur në të. Nga kjo pikëpamje...

(Diskutime pa mikrofon)

Vijmë po te e njëjta gjë, pronari do të merrte mbrapsht atë tokë, si tokë apo si normë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nga kjo pikëpamja vetë...

Eduard Shalsi – Ju lutem, jini të kujdesshëm kur shpreheni, sepse çdo gjë regjistrohet!

Vangelt Duni – Nga kjo pikëpamje ne nuk kemi tentuar të hedhim poshtë ndarjen e tokës që është bërë nëpërmjet ligjit nr. 7501, thjesht jemi munduar t'i marrim si të mirëqena ato devijime nga parimi i ligjit në rastet kur janë bërë në favor të kësaj kategorie. Nga kjo pikëpamje vetë ligji nr. 7501, ka qenë një cenim i parimit të sigurisë juridike.

Eduard Shalsi – Majlinda, e ka fjalën.

Majlinda Bozgo – Në ligjin nr. 7501, është shkruar shprehimisht: “Nuk njihet masa dhe kufijtë e vjetër”. Nëse gjatë zbatimit të tij një familje bujqësore i është dhënë aq sipërfaqe sa i takonte mbi tokën e babait, me eksperiencën dhe me kuptimin tim është zbatimi më ideal i këtij ligji. Pra, ligji nr. 7501 nuk mori përsipër në asnjë rast t'u jepte tokën ish-pronarëve ashtu siç e kanë pasur, por këtë ndryshim e bëri VKM-ja nr. 452 për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore vetëm për tokat e qyteteve, të cilat kishin qenë toka të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe pronësia e tyre ishte e qytetarëve të atij qyteti. Edhe këtyre qytetarëve nuk iu dha e gjithë toka që kanë dorëzuar, por iu dha aq sa u takonte me normën për frymë, sipas gjendjes në momentin kur kanë dorëzuar tokën. Ne teorikisht i jemi referuar regjistrimit të popullsisë në periudhën 1945-1950, por jo më tepër se sa kanë dorëzuar.

Pse e kundërshtojmë këtë pikë? Në të gjitha aktet që kemi bërë në zbatim të të gjitha ligjeve për tokën e kemi respektuar kategorinë e bashkëthemeluesve me të gjitha të drejtat e tyre, por në këtë rast flitet vetëm për ata, të cilët janë trashëgimtarë të atyre që u është marrë prona në '45-'46, por në asnjë rast nuk thuhet, ashtu siç thuhet te 452-i: “Jo më shumë se sa kanë dorëzuar”. Ku do të referohemi për t'i njohur si ish-pronarë? Çfarë sasive toke do t'i pranojmë për të marrë apo cilët nga trashëgimtarët e atij që ka dorëzuar? Mund të ndodhë, në kuptimin e përgjithshëm, po supozoj, gjyshi im e ka pasur tokën atëherë dhe sot e kam marrë unë që jam një nga shtatë trashëgimtarët e gjyshit. Po ata të tjerët që janë bashkëtrashëgimtarë njëloj si unë si do të trajtohen në këtë rast? A u mbetet atyre e drejta te Komisioni i Kthimit të Pronave,

ndërkohë që unë mund ta kem marrë të gjithë sipërfaqen që gjyshi im ka pasur? Pra, ne nuk jemi kundër përfitimit të kategorisë së ish-pronarëve në këtë rast, por jemi për të përcaktuar kriteret e qarta që askujt të mos i cenohet e drejta...

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Madje ligji i kthimit të pronave fillimisht thoshte se ata që kanë marrë me 7501-in...

Majlinda Bozgo – Praktikisht kështu është. Ne nuk jemi kundër, por jemi vetëm për saktësim.

Artan Lame – Do t’ju bëj shpjegimin e fundit për këtë pikë dhe tërhiqem nga këto lloj diskutimesh.

Në qoftë se të gjitha qeveritë kanë dështuar për t’i mbyllur këto procese, fakti është se kanë mbetur rob të 7501-it dhe rob të zbatimit edhe atje ku ai kishte dështuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, më lini ta mbaroj fjalën!

Ju po rishihni ta rihapni, ndërsa unë po ju them se dua ta mbyll si proces...

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame - Në qoftë se ne i rihyjmë procesit për secilën familje, se këtu dolëm prapë te 45-a, u nisëm për ’91-in dhe dolëm te ’45-a, do të mbetemi prapë te merimanga e 7501-it. Pra, është absurde që ne prapë këtu sot diskutojmë për ligjin nr. 7501....

Eduard Shalsi – Kjo shkon në kundërshtim me atë që thotë...

Artan Lame – Unë e marr të mirëqenë, ti që ke një titull pronësie dhe ke marrë një AMDP, nuk hyj dhe nuk e vë fare në diskutim, ndërsa ju po rihyni prapë të vlerësoni AMDP-në, sepse është e thjeshtë të mbetesh te ngërçi i 7501-it, kurse unë nuk i futem fare. Ti e ke marrë AMDP-në dhe unë nuk i hyj fare për ta vlerësuar se si e ke marrë, por nisem nga fakti që ti në fshat ke një AMDP dhe ke një tokë, hallall e paç, ik vazhdo...

(Diskutime pa mikrofon)

Ja, e hoqa, çfarë do të bëjmë me ata atje?

Çfarë do të bëjmë me ata që e kanë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse ligji nr. 21 nuk e lejon ta regjistrojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ka qenë në vitin 1991 3 vjeç, sot është 28 vjeç.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk kërkon asnjë gjë.

Ermira Gjeci - Po flasim për rastin kur këto subjekte kanë aktmarrje në pronësi. Pra, duke shmangur ligjin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne po flasim për kriteret e ligjësimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë kategoria e ish-pronarëve, të cilët tokën e tyre që duhej ta merrnin nëpërmjet procesit administrativ të kthimit të kompensimit të pronave, e kanë marrë nëpërmjet një akti të marrjes së tokës në pronësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Problemi është se këtu përzihen gjërat për aq kohë sa duhet bërë ligjësimi i këtyre akteve. Jemi në një proces që të gjitha aktet e marrjes së tokës në pronësi nuk regjistrohen në zyrat e regjistrimit pa iu nënshtruar verifikimit aktualisht me ligjin e verifikimit të titujve të pronësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - Unë e mbyll te kjo që, nëse ke një AMTP dhe ke marrë tokën atje, nuk i hyj t'ia vlerësoj AMTP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Më falni, te neni 8 më poshtë bëhet pikërisht ajo që drejtori po kundërshton. Trajtimi i titujve që nuk përmbushin kushtet për ligjësime. Pra, ju i verifikoni disa kushte dhe kushtet konkretisht të nenit 7, pra vendosni çfarë emri të doni “verifikim”, “kontroll kushtesh”, “ligjësime”. Në fakt, AMTP-së i shikohen disa kushte 1,2,3,4, nëse nuk i plotëson, dërgohet në gjykatë. Ne kemi edhe një koment për këtë nen, sepse ka një gabim të madh ligjor edhe në këtë nen.

Artan Lame- Kjo është historia dhe unë nuk dua të hyj të vlerësoj AMTP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi- Ju keni punuar nga pikëpamja teknike, sepse ka një gjë që është keqkuptim i madh, por jemi në një linjë me këtë që thotë Lame, madje kjo që sapo thatë tani përforcon sugjerimin e tyre.

Pra, AMTP-në çfarë e pengon të regjistrohet?

Lorena Goxhobelli - Nuk regjistrohet, sepse nuk përmbush kushtet për t'u regjistruar, sepse çdo AMTP para se të regjistrohet i nënshtrohet një procesi kontrolli, konfirmimi dhe verifikimi. Ky rast është një kategori që nuk i përmbush këto kushte me ligjin aktual për verifikimin e titujve të pronësisë, sepse nuk ka qenë anëtar i kooperativës bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valgent Duni - Fakti është që aktualisht nëse përfituesi i AMTP-së rezulton që të mos ketë qenë banor, minimalisht banor në njësinë ku ka përfunduar AMTP-në, atëherë ajo i konsiderohet e pavlefshme dhe në bazë të ligjit për verifikimin e titujve niset një procedim administrativ dhe më pas një procedim gjyqësor për arritjen e anulimit të AMTP-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - Ishte kusht që ai do të merrte qytetarët e atij rrethi, pra nuk mund të merrte ai nga Tirana në Fier. Pra, banor i qytetit të Fierit do të merrte brenda fermës në Fier, ky ishte kushti. Lëvizën njerëzit në vitin 2000, por Saliu tha se kush është ky, ka marrë ky tokë, hiqja këtij dhe bëri ligjin që për mua nuk ishte efektiv.

Valgent Duni- Çështja së cilës i drejtohet kjo dispozitë është më e gjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli - Bashkëthemeluesit janë subjekt i ligjit të kohës. Në fakt, verifikim të kushteve të ligjësimit do të ketë me këtë ligj, por debati që po bëjmë këtu është çfarë do të kontrollohet.

Bashkëthemeluesit janë subjekte të ligjit, mund t'i kenë regjistruar AMTP-të, vazhdojnë t'i regjistrojnë, nuk i cenon asgjë. Ajo që ne nuk jemi dakord është me hapjen përtej subjekteve të ligjit. Pra, edhe për ata persona të cilët janë ish-pronarë, ne nuk e kemi të qartë mbi çfarë kriteresh dokumentacioni, janë të tillë sa tokë kanë dorëzuar, sepse është një fashë njerëzish për të cilët nuk kemi asnjë lloj informacioni.

Eduard Shalsi – Kush e ka draftuar këtë?

Artan Lame - E thënë troç është kjo kemi të bëjmë me një kategori që e kanë marrë AMTP-në, e kanë titullin e pronësisë dhe tokën. Sot këta me këtë tokë dhe këtë titull nuk e regjistrojnë dot.

Eduard Shalsi - Këtë po thotë Berti.

Artan Lame- Nuk janë bashkëthemelues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valgent Duni - Çështja është se në analizë të fundit, siç po e thosha pak më parë, bashkëthemelues ose jo në bazë të ligjit për verifikimin e titujve të ligjit aktual, nëse subjekti që ka përfituar AMTP-në nuk provon se ka qenë anëtar i kooperativës bujqësore në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit ose të paktën 01.08. 1991, atëherë AMTP-ja e tij konsiderohet e pavlefshme.

Lorena Goxhobelli - Gabim, sepse ka edhe punonjës që nuk kanë qenë banorë dhe kanë marrë gjysmën e normës për frymë deri në 4 veta.

Valgent Duni - Po për ta përmbledhur duhet të kenë qenë banorë të asaj njësie të atij fshati deri në 01.08.1991, jo të gjithë bashkëthemeluesit e kooperativës kanë qenë banorë kanë qenë të tillë.

Lorena Goxhobelli - Koncepti i bashkëthemeluesve nuk shtrihet në kooperativa, por vetëm nëpër ferma.

Valgent Duni - Pikërisht për ish-ndërmarrjet bujqësore njihet bashkëthemeluesi, për kooperativat jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë, por ka persona dhe subjekte, të cilëve iu është marrë toka kanë kontribuar në formimin e kooperativave bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam duke folur se gjatë krijimit të kooperativave bujqësore pas vitit 1945 ka pasur persona të cilëve iu është marrë toka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - Ne nuk i hyjmë më të analizojmë AMTP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Sa masiv është ky problem? Nga ka lindur ky problem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë them që ky është kapitull i mbyllur, nëse ai ka tokën atje në fshat dhe ka AMTP-në është absurde t'i hysh analizës.

Lorena Goxhobelli - Në nenin 8 thuhet: “Për aktet e marrjes së tokës në pronësi, të cilat nuk për mbushin kushtet e përcaktuara më lart”, ka verifikim të kushteve të ligjësimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë tre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ky është debati për sa kemi.

Eduard Shalsi- Zoti Lame, do t'ju lutem ju dhe cilido tjetër që t'i heqim këto etiketimet "i bezdisshëm" për njëri-tjetrin. Në këtë komision nuk i lejoj. Ka një problem të madh se nuk jemi mësuar të debatojmë. Nuk ka asnjë problem nëse zihemi, por edhe sqarohemi.

Artan Lame- Po ne kemi 3 muaj që debatojmë

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka kaluar në qeveri dhe është mbyllur si qeveri.

Eduard Shalsi- Mesazhi nga qeveria. Kryetar i nderuar për efekte

(Ndërprerje incizimi)

Artan Lame-Do të heqim rregulla, apo do të shtojmë edhe një herë nga fillimi rregulla? Ne këtu nuk jemi mbledhur për të rivënë në funksionim parimet e ligjit nr.7501, i cili na solli në këtë derexhe, jemi vënë për të mbyllur proceset që ka lënë hapur ndër të tjera ligji nr.7501.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Unë po të them se ajo dispozitë të thotë që, nëse ka marrë AMTP-në, po ka tokën atje, nuk i hyjmë të analizojmë si e ka marrë atë ATMP.

Ne kemi lënë ca kushte. Kjo këtu është tabela që është hartuar. Do të doja që të shikonit matricat si miratohet një AMTP sot, pra nga procesi i parë, në sa hallka kalon për të arritur deri sot. Ky shtet kohë pas kohe sa herë i ka dalë para një vështirësi, është munduar ta zgjidhë duke bërë ca letra të tjera pa parë që duke prodhuar letra thjesht e ka penguar procesin, por nuk e ka mbyllur. Ne nga gjithë kjo mori letrash themi i mbyllim të gjitha, sepse këto 25 vjet shërbyen që njerëzit ta gjejnë rehatin me njëri- tjetrin dhe të lëmë vetëm 2, ose 3 ose 4 kushte të domosdoshme. Pra, neni që thotë këshilltarja është neni që ka lënë 2,3,4 kushte që janë të domosdoshme, për shkak të një shqetësimi të drejtë të Ministrisë së Bujqësisë, ka të bëjë me infrastrukturën e bujqësisë që do të thotë aty ku ka ndarje me AMTP, ku bllokojnë infrastrukturën u tha sot që kanë ndarë AMTP në liqen. Mua më duket e pamundur megjithatë duhet ta vëmë si kusht. Hapja çdo lloj procedure, sipas parimit sa i takonte dhe si i takonte, do të na lërë këtu ku jemi. Ai ka një tokë që e punon, ka edhe një dokument të cilin ky shtet me

paaftësinë e vet ia ka dhënë, nuk i hyn dot përveçse në rrugë gjyqësore, që do të thotë qindra gjyqe pa sens.

Eduard Shalsi –Prandaj ne themi që kemi disa pronarë që janë de fakto pronarë të tokës. Me çfarë dokumenti? Nuk kanë dokumentin. Por po e hapim lojën edhe për ata që nuk e kanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame -Ligji nuk është për hapjen e proceseve tranzitore nga fillimi.

Eduard Shalsi -Vazhdojmë te pika tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame– Ligji nr.7501 është shumë i mirë, sepse ishte një shtet që mendonte se do të funksiononte. Pra, është problemi që ai ligj u mendua se do të bëhej funksional vetëm po të kishte shtet që të detyronte. Në momentin që ra shteti që të detyronte, ligji degradoi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Te neni 7, pika 1, germa “c”: Toka e ndarë nuk ka qenë e llojit truall rërë bregdetare ose plazhë. Ne mendojmë që formulimi të jetë i ndryshëm. Duke qenë se flasim për kushtet e ligjësimi, duhet të thuhet : Toka e dhënë me aktin e marrjes së tokës në pronësi figuron e kategorisë së resursit tokë bujqësore në regjistrin kadastral të datës 01.08.1991”, sepse ky është parimi. Pra, nuk mund ta nisësh një fjali qoftë nga ana e teknikës legislative, sepse është tërësisht e gabuar, nuk duhet të jetë dhe më pas duhet të përmendet përjashtimi për të cilën kemi rënë dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Toka e dhënë me aktin e marrjes së tokës në pronësi figuron e kategorisë së resursit tokë bujqësore në regjistrin kadastral më 01.08.1991, edhe kur aktet e marrjes së tokës në pronësi janë dhënë në toka që, sipas regjistrit kadastral, më 01.08.1991 figurojnë në kategorinë e resursit livadh, tokë bujqësore, kullotë konsiderohen të vlefshme nëse aktualisht rezultojnë të jetë tokë e mbjellë me kultura bujqësore dhe bëhet ndryshimi i kategorisë së resursit sipas legjislacionit aktual. Pse është vetëm për tokë pyjore, livadh, kullotë? Sepse ka pasur raste që në praktikë një ish-ndërmarrje ose ish-kooperativa, që kanë qenë toka bujqësore, që punoheshin, por nuk ishte bërë ndryshimi në zërin kadastral dhe ne themi lejohet vetëm për këtë kategori. Nëse do t'i qëndrojmë formulimit siç është bërë në projektligjin që kemi para, thuhet tokë e ndarë me ATPM nuk ka qenë e llojit truall rërë bregdetare plazhe. Pra lë jashtë tokën e pafrytshme, që mund të

jenë shtretërit e lumenjve. Për shembull na është bërë me dije që në kuotat e rezervuarit në Dibër, ku ka AMTP të dhëna, nëse e lexojmë në këtë formë, ai person, duke qenë se nuk i futemi verifikimit të AMTP-ve, shkon dhe e regjistron dhe ka AMPT-në në një zonë që konsiderohet sipërfaqe ujore, prandaj mendojmë të bëhet në formën siç e kemi propozuar.

Ilir Beqaj – Zonjë, ju kërkoj ndjesë, por në atë pozicionin tënd unë kam qenë për herë të parë në vitin '94.

Ju lutem shumë, të gjithëve ju që vini, deklarime të tipit “tërësisht e gabuar” ju lutem mos prononconi për askënd, sepse “tërësisht e gabuar” është vetëm për rastin kur $2+2=5$, sepse në vend që të merremi me thelbin, pastaj merremi me komunikimet me njëri-tjetrin.

Lorena Goxhobelli – E tërheq. Do ta modeloj.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj – Kemi raste në zonat tona që, duke u nisur nga logjika juaj, zoti Lame, që gjysmën e ka marrë tokë bujqësore, gjysma tjetër e ka emrin “kullotë” dhe i ka ngelur pa e marrë atë dokument vetëm për këtë fakt.

Unë mendoj se kemi një mundësi edhe te pika 3 e këtij neni, ku thuhet: “Mosplotësimi i kriterëve të akteve ligjore e nënligjore për tokën bujqësore që nuk janë listuar në pikën 1 të këtij neni, përfshirë normën për frymë apo tokën kullotë”. Pra, ta shtojmë edhe “tokën kullotë”, që të ligjërohet.

Lorena Goxhobelli – Ne e kemi përfshirë te pika “c”. Nga aspekti ligjor, duke qenë se listohen kushtet që duhet të plotësojë një titull pronësie, zëri kadastral...

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Është e qartë.

Urdhëroni!

Artan Lame – Propozimi i Ministrisë së Bujqësisë kërkon që ne të kthehemi në një lloj agjencie që vlerëson tokën bujqësore dhe bën vlerësimin nëse e mbjell apo s’e mbjell, nëse e ka mbjellë apo s’e ka mbjellë.

Nuk dua t’i hyj atij diskutimi dhe nuk ka tagër t’i hyj që të shohë nëse toka e përfiton AMTP-në vetëm nëse toka e pafrytshme apo kullota përdoret sot për qëllime bujqësore. Nuk ka topograf që përcakton këtë...

(Diskutime pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Qëllimi i këtij ligji ka të bëjë me pronësinë në tokën bujqësore dhe duke qenë se flasim për pronësi në tokën bujqësore, atëherë flasim për një sipërfaqe, e cila është bujqësore sot, por nuk është bërë ndryshimi në regjistrat kadastral më 1.8.1991, pra nuk ka të bëjë me kulturën që mbjell, ka të bëjë me faktin nëse është tokë bujqësore apo jo.

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Unë i them se, në qoftë se ai ka një AMTP për atë sipërfaqe, nuk më intereson fare nëse është livadh apo është kullotë, ka AMTP-në...

(Diskutime pa mikrofon)

Diferenca qëndron në faktin se ne themi e ke AMTP-në, bujqësore apo kullotë nuk më intereson, unë ta regjistroj, kurse këta thonë që kullotën ta regjistrojë vetëm nëse sot përdoret për qëllim bujqësor, pra është e mbjellë me kulturë bujqësore.

Unë them që nuk i hyj fare kësaj çështjeje.

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Unë kam një rast, që ka AMTP-në ai zotëria dhe gjysmën e tokës e ka bujqësore, gjysmën e ka kullotë. Shkon në zyrën e regjistrimit të pasurive dhe nuk ia regjistron se i thonë që figuron kullotë.

Ndërkohë, ju thoni se e keni njohur AMTP-në, e regjistron dhe është në rregull, u zgjidh problemi.

(Diskutime pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Ne e zgjidhim problemin, por themi meqenëse ajo është tjetërsuar, sot nuk është kullotë dhe kjo ka ndodhur për hir të një problemi në momentin e parë, që nuk është transformuar, nuk është tjetërsuar. Ne themi që ajo sot është tokë bujqësore dhe të regjistrohet si tokë bujqësore. Qëllimi i të gjithës është të evidentohet toka bujqësore dhe fermerët, në fund të fundit, të arrijnë të vërtetojnë që kanë tokë bujqësore me letra dhe punojnë tokën bujqësore. Domethënë ka qenë kullotë dhe ne themi që ai sot e ka bërë tokë bujqësore, e ka mbjellë dhe ne i themi që mos e regjistro si kullotë, por të regjistrohet si tokë bujqësore.

Artan Lame – Jo, ti s'po thua këtë. Ti po thua që të ngrihet komisioni, të vërtetojë që mbillet me kultura bujqësore, pastaj të bëhet ndryshimi në zërin kadastral, pastaj të regjistrohet.

Unë them që qëllimi i agjencisë është të regjistrojë titullin e pronësisë dhe të bëjë verifikimin e saktë në terren të titullit të pronësisë. Nuk mund t'i hyjë agjencia të bëjë verifikimin nëse është sot e mbjellë apo jo.

(Diskutime pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Kjo ka të bëjë edhe me një detyrë kryesore që ka Ministria e Bujqësisë, me administrimin e tokës bujqësore.

Eduard Shalsi – Majlinda, ki një gjë parasysh, filozofia gjatë gjithë këtyre 25 vjetëve ka qenë që ta saktësojmë këtë, që ta saktësojmë këtë dhe ta saktësojmë këtë dhe kjo na ka çuar te ajo skema që për të marrë një dokument duhej të kaloje nëpër 25 apo 30 zyra.

Thelbi është se ne po miratojmë dy gjëra duke i ndarë me shpatën e Damokleut, jo t'i shthurim gjërat.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk me duket se i ngatërroj më keq për dy-tri ndërhyrje që bëj, përkundrazi, unë mendoj se i japim një instrument, me përjashtim të dy gjërave që i kam të paqarta, por të gjitha këto janë një instrument për ta ndarë ...

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Zoti Bitri, nuk e kuptoj shqetësimin tënd, kur ne pikërisht këtë mundohemi të shmangim. Pse e ke frikën që kjo po e komplikon më tepër?

(Diskutime pa mikrofon)

Robert Bitri – Hajde ta mbyllim, por ta mbyllim duke e kopsitur.

Burrë - Ku cilësohet në ligj se ata që kanë tokën kullotë e marrin certifikatën e pronësisë?

Majlinda Bozgo – Në dispozitë ne kemi ndjekur logjikën e përjashtimit. Pra, kemi listuar rastin se kur nuk legjitimohet ose për ta thënë me fjalë të thjeshta, kemi listuar se kur subjekti nuk mund ta regjistrojë dot AMTP-në...

(Diskutime pa mikrofon)

Pika 3 ka thjesht efekt deklarativ, sepse ne kemi pasur gjatë gjithë kohës kontradiktë...

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord, por mund të lëmë ndonjë kategori pa përfshirë, ky është problemi. Duhet t'i përmendim të gjitha.

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Meraku që ka Ministria e Bujqësisë për infrastrukturës, por që s'duhet konsideruar thjesht si merak i saj, por i të gjithëve, do ta vëmë te kriteret përjashtuese, aty ku

është ndarja me AMTP-në, që prekin infrastrukturën publike ose bujqësore. Pra, kanë ndarë me AMTP-në kanalin...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, po e fusim te përjashtueset, ku përveç atyre që kemi thënë, rërën, truallin etj., ta shtojmë edhe këtë...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, biem dakord me këtë që do të vëmë te pengueset infrastrukturën publike dhe bujqësore (do ta gjejmë termin juridik), duke lënë Këshillin e Ministrave të përcaktojë një VKM, ku të detajojë se cila do të quhet distanca etj.

(Diskutime pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Neni 8 flet për trajtimin e titujve që nuk përmbushin kushtet për ligjësim. Aty thuhet që për aktet e marrjes së tokës në pronësi, të cilat nuk përmbushin kushtet e përcaktuara, të cilat i diskutuam deri tani, veprohet si më poshtë:

- Kur pronari aktual i tokës është ende përfitues fillestar i AMTP-së, titulli është i pavlefshëm dhe dërgohet në Gjykatën e Apelit.

- Në rastin kur përfituesi fillestar, si pasojë e një transaksioni apo shpronësimi nuk e disponon më tokën, nuk parashikon mundësinë e të dërguarit në gjykatë, por detyrohet që për sipërfaqen përkatëse të kryej një pagesë.

Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, nr.29, datë 31.5.2010, i cili thotë që në rrugë administrative një titulli pronësie vetëm mund t'i konstatohet pavlefshmëria, por jo të shfuqizohet. Duhet të dërgohet patjetër në gjykatë.

Pra, është e nevojshme të parashikohet gjykata në të dy rastet, edhe kur përfituesi fillestar i AMTP-së është pronar, edhe në rastin kur ka ndodhur transaksioni.

Ne e kemi riformuluar dhe e kemi sjellë këtu.

Eduard Shalsi – A jeni dakord?

Dakord.

Vullnet Sinaj – Kur thoni pronari aktual i tokës, që është përfitues fillestar i AMTP-së, çfarë kuptoni me këtë?

Çfarë ndryshimi ka ky nga ai tjetri?

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Deri tani thamë se cilët pengohen nga ata që e kanë marrë AMTP-në, pra nga infrastruktura bujqësore, rëra dhe trualli. Në këto tre raste AMTP-ja quhet e pavlefshme.

Në këtë nen do të shohim se çfarë bëhet me këtë që i del AMTP-ja e pavlefshme.

Në qoftë se AMTP-në e ka direkt ky personi që e ka marrë, agjencia e çon në Gjykatë të Apelit...

Vullnet Sinaj – Pra, bëhet fjalë për kushtet e mësipërme. Po pse nuk e cilësoni këtu?

Artan Lame – Trajtimi i titujve që nuk përmbushin kushtet për ligjësim...

Lorena Goxhobelli – Neni 9 është një ndër nenet për të cilin ne kemi pasur debatet më të mëdha. Flasim për posedimin e atyre tokave, të cilat janë mbi AMTP, domethënë mbi titullin e pronësisë.

Deri tani po flisnim për tokat që posedohen me një titull pronësie, kurse tani po flasim për tokat që posedohen pa një titull pronësie mbi titullin e pronësisë.

Projektligji parashikon shitje deri në 20% të tokës së poseduar mbi AMTP, e detyrueshme kur toka është pronë shërbyese (po citoj projektligjin në këtë rast dhe pastaj do të them kundërargumentin) dhe pastaj kalimin e saj në një fond toke bujqësore dhe dhënien e saj në përdorim, thotë neni 9 i përmbledhur në një fjali.

Mendimi i Ministrisë së Bujqësisë është se i qëndrojmë në parim propozimit për shitje vetëm të 10% mbi sipërfaqen e dhënë me AMTP, ose me qira pa konkurrim të të gjithë sipërfaqes në përdorim faktik.

10% është norma e pranuar edhe sipas legjislacionit aktual, konkretisht në nenin 9, parashikimi i sipërfaqes së ofruar për t'u blerë në masën 10%, edhe pse duhet pranuar që nuk ka asnjë lloj studimi, ka pasur si logjikë impaktin e gabimeve që mund të kishin ardhur nga pasaktësitë gjatë procesit të matjes së tokës bujqësore.

Gjithashtu, sugjerojmë të mos përdoren në ligj koncepte të tilla, si “pronë shërbyese” apo “pronë kryesore”, të cilat do ta ndërlikonin procesin dhe mund të linin vend për subjektivitet.

Ideja është se debati që kemi bërë, është bërë si lojë kungulleshe, pse 10, po 20. Të paktën, sugjerimi ynë ka qenë që 10 mund të jetë edhe në kuadrin e gabimeve që mund të kenë ndodhur nga pasaktësitë e matjeve, ndërsa 20 mund të jetë diçka më shumë dhe, padyshim, nuk e zgjidh tërësisht faktin se mund të ketë edhe mbi këtë 20% dhe, gjithsesi, do të ngelet një rrip toke, merakun që kanë pasur gjithmonë.

Ne po flasim për sipërfaqen për të cilën fermeri është pajisur me AMTP, por përveç faktit që ai ka dokumentin, qoftë edhe të regjistruar, ai ka zaptuar edhe një sipërfaqe tjetër tokë, të cilën e ka apo nuk e ka në përdorim.

Ajo që ne themi është që le t'i regjistrohet AMTP-ja, ashtu siç ka qenë subjekti i ligjit, me marzhin e gabimit 10%, ashtu sikurse është ligji aktual.

Zoti Lame dhe grupi propozojnë që ky marzh të jetë 20%.

Në mbledhjen e qeverisë u aprovua ligji me kushtin që deri në momentin e vajtjes në parlament mendimet e Ministrisë së Bujqësisë do të diskutoheshin dhe do pasqyroheshin në projektligj. Ky ka qenë vendimi i KM-së.

Ne kemi diskutuar dhe kemi thënë, meqenëse flasim për dy numra, si 10%, si 20%, të cilët janë numra që nuk janë të bazuar në të dhëna aktuale, se nuk i dimë sipërfaqet e zaptuara dhe meqenëse nuk duam që nëpërmjet këtij ligji të themi përsëri që ata që kanë zaptuar do të legjitimohen, 10%, siç është ligji aktual, dhe diferencën kur ti e përdor do ta marrësh me kontratë qiraje pa të drejtë konkurrimi, që do ta japë bashkia, domethënë nuk do të hapet tender ku ai të konkurrojë, ose akt të marrjes së tokës në përdorim, me arsyen e vetme, duke mos pasur bilancin e tokës bujqësore sot në Republikën e Shqipërisë, duke mos ditur se cili është vendi, sepse këta që kanë zaptuar, kanë zaptuar tokën e Ministrisë së Bujqësisë, kanë zaptuar tokën e bashkisë, kanë zaptuar tokën e ish-pronarëve apo kanë zaptuar toka të institucioneve të tjera.

Duke mos ditur gjendjen aktuale themi faza e parë me qira ose në përdorim dhe në një fazë të dytë, pasi të regjistrohet, do të jemi në gjendje të gjerë për shitjen ndaj subjekteve të cilët e përdorim.

(Diskutime pa mikrofon)

Do t'i japim dokument.

(Diskutime pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Po edhe te 20 do të mbetet, sepse nuk e...

Eduard Shalsi - Ju lutem! Një sekondë!

Pesë minuta ju lashë...

Vullnet Sinaj - Teorikisht mund të themi çfarë të duam. Fakti që sot Ministria e Bujqësisë thotë: “Ka të drejtë”, sepse mendon për rripat e tokës që do të mbeten dhe çfarë do të bëhet me ato është e drejtë, 20%- shi është normë, e kanë dhënë vetë, fshatari i prirë për të marrë tokën, kur e ka matur komisioni i fshatit u ka dhënë të gjithëve nga 20% më tepër. Shifra

që propozon zoti Lame është e saktë. Problemi është: çfarë do të bëhet me rripat e vegjël që do të mbeten? Prandaj u jepni mundësi që ata ta bëjnë.

Kam edhe një gjë tjetër: 20%-shin duhet ta përfitojnë kur nuk bie kanal apo rrugë, sepse mund t'u bie kanal, rrugë dhe të marrin edhe këto të fundit.

Te ky nen parashikohet se ata që kanë tokë më pak sesa kanë AMTP, do të regjistrohen sipas tokës që kanë. Kemi raste të fshatarëve që i kanë pasur tokat buzë lumit. U ka mbetur AMTP-ja dhe nuk kanë asnjë copë tokë. Ky ligj nuk e zgjidh këtë, duhet një zgjidhje.

Majlinda Bozgo - Nuk bëhet fjalë vetëm për rripa, bëhet fjalë edhe për sipërfaqe më shumë sesa 20%. Po ai tjetri që nuk ka marrë?

Vullnet Sinaj - Ju lutem!

Artan Lame- Unë njoh njerëz që kanë zaptuar hektarë të tërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi –A e mbani mend se çfarë kemi kërkuar në këtë komision? Dy vjet më parë kërkuam dhe na dhanë 3 harta për të krijuar një ide se për çfarë rripash toke bëhej fjalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta them 100 herë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse nxitohesh? Nuk keni durimin të dëgjoni njëri-tjetrin!

Para 2 vjetësh nuk e di se kush e solli nga Ministria e Bujqësisë dhe u thamë: a na e jepni me pamje që të kuptojmë se për çfarë 10-20 %-shash bëhet fjalë? Na sollën disa harta, ku ishin disa rripa për të cilët ne më parë kishim krijuar bindjen se janë në përmasa të mëdha, të cilat do t'i shërbenin ministrisë. Pra, bëhej fjalë për disa rripa toke, nëse kjo është masa më e madhe, që përveçse t'ia shesim atij që e ka në përdorim, nuk ka absolutisht asnjë lloj zgjidhjeje tjetër.

Zoti Beqaj, u nisëm nga realiteti, nuk u nisëm nga të dhënat, pasi këto të fundit ishin dhe tregonin qartazi që bëhej fjalë për disa rripa toke, të cilat nëse nuk vazhdonin t'ia shisnin me një çmim atij që po i përdorte, nuk i hynin në punë as dreqit.

Zoti Lame, a keni ndonjë gjë për të shtuar? Unë jam shumë i qartë në këtë histori.

Artan Lame - Kam për të shtuar një gjë që është shumë e rëndësishme, ka qenë një nga pikat realisht kyçe që e bënte funksional mekanizmin, sepse funksionon te legalizimet. Te legalizimet skema ishte tillë, kemi një eksperiment që ka dhënë rezultat: “ Do të marrësh

trefishin e sipërfaqes së objektit, por jo më shumë se 500 -metra”. Pra, nëse e ke objektin 200 metra, trefishi është 600 metra. Nuk do të marrësh 600 metra, por do të maresh deri në 500. Nëse mbeten përtej kësaj rripa të papërdorshëm për funksione të tjera, kur nuk mund të bësh një parcelë tjetër, ku mund të përdoret 500 metërshi, atëherë do ta blesh edhe atë. Kjo gjë, na funksionoi tek ALIUZN-i dhe me këtë logjikë thamë që ta transferojmë tek tokat bujqësore. Ishim të bindur se në çdo gjë mund të na dilte problem me Ministrinë e Bujqësisë, por vetëm tek kjo jo. Me gjithë argumentet e kësaj bote që kemi dhënë, rezistenca e Ministrisë së Bujqësisë ka qenë deri në fund ekstreme. Prandaj këmbëngul që ta bëj edhe shpjegimin e saj, sepse e di që Ministria e Bujqësisë do të vazhdojë të këmbëngulë për jo. Në këtë pikë kam të drejtën që të them dy fjalë.

E para, Ministria e Bujqësisë nuk mund të kthejë në meritë një gjë që nuk e ka bërë. Fakti që nuk ka të dhëna të sakta për situatën në vend, nuk mund ta kthejë në meritë dhe të thotë: “ Meqenëse nuk kemi të dhëna të sakta për situatën e kësaj gjëje, ne themi që të mos ndryshojë 10%-shi”.

E dyta, nëse e kthejmë në çështje 10% apo 20% ligji i sotëm e ka 10%. Ne pretendojmë ta bëjmë 20-%, sepse kjo është agjencia e cila do ta zbatojë. Çfarë arsye ka Ministria e Bujqësisë të thotë: “Ne jemi kundër asaj që pretendoni ju të zbatoni një ligj, që do ta zbatoni po ju”.

E treta, vijmë te rasti tipik dhe do të dëshiroja t’ju jepja një shembull. Me ministrinë e kemi diskutuar. Shembullin e përgatitëm ne, sepse ministria nuk solli asnjëherë një shembull real.

Eduard Shalsi - Zoti Beqaj, shikoje pak atë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Zoti Artan Lame flet pa mikrofon)

Artan Lame – U bë edhe ndarja e certifikatave, me ngjyrë blu janë parcelat e banorëve, me të kuqe janë tokat shtet, që janë dhënë për shkak të matjeve që janë bërë në 1991 që janë bërë me litar e të tjera.

Këtë tokën këtu e ka zënë, sepse ai e dinte që deri këtu e ka.

Pra, ajo që thotë ministria nuk qëndron.

AMTP-ja më e madhe është 2 hektarë. 20% do të marrim ekstremin.....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ia merr dot. Pra, nuk mund të marrë pa fund.

Kjo vija këtu është 2 metra e gjerë dhe 200 metra e gjatë. Logjika deri në 20% e merr, nëse

Çfarë qiraje do shkosh t'i marrësh kur ai e përdor.

(Diskutime pa mikrofon)

Mos u gëzo kaq shpejt!

Majlinda Bozgo - Jo, nuk gëzohem!

(Zoti Artan Lame diskuton pa mikrofon)

Po ta shkoni, këtë me fotografi më poshtë ky e ka serë dhe ne i themi sot që këtë pjesën këtu do ta heqim, kur ky e ka mbjellë.....

(Zoti Ilir Beqaj flet pa mikrofon)

Vullnet Sinaj- Zoti kryetar, nuk kam mbaruar. Te ky nen kam dy probleme: kam problemin e atyre që nuk kanë tokë fare, që u ka mbetur AMTP-ja dhe u ka dalë lumë AMTP-ja, sepse ua ka marrë tokën lumi: kam edhe problemin e zaptimit, jo të atij që thoni, ju, që ka zënë një tokë bosh, por ai ka marrë tokën e AMTP-ve të tjerëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Çfarë ka ndodhur në fshatin Gjorm? Kam ardhur dhe ta kam thënë në zyrë: tri familje kanë marrë tokën e 40 familjeve, ish –pronarë të vjetër. 40 familjet kanë AMTP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kanë zaptuar me forcë. 40 familjet paguajnë taksat për AMTP-në që kanë, ndërsa 3 familjet e kanë marrë tokën. Ligji nr. 7501 parashikonte zaptimin, ndërsa ju e keni hequr fare. Ku do të shkojnë të mbyten ata?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, mos i ngrini kot agjencitë në njësitë administrative! Agjencia dhe njësia administrative duhet të bëjnë edhe verifikimin e të këtyre zaptimeve dhe të bëjnë denoncimin në organet gjyqësore apo prokurori për ata që kanë zaptuar tokën dhe mos ua lini fshatarëve. Kjo është e nevojshme në këtë ligj.

Artan Lame – Ndihej i kënaqur që shikoj sesa kollaj u kuptua dhe u mbështet kjo gjë. Erdhi një moment që u dekurajua nga rezistenca e Ministrisë së Bujqësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj pas 3 muajsh që po më del shpirti me këtë histori nuk cedonin gjëkund.

Zoti Shalsi, po i kthej përgjigje zotit Beqaj.

Ne e kishim edhe më të lëshuar këtë gjë, por për shkak të presionit dhe të rezistencës ne e ulëm. Prandaj ta përmenda këtë dhe nuk t'u lavdërova. Ne u tkurrëm, se e pamë që ndryshe nuk kalonte. Në fund edhe pasi ceduam, na thanë: “Nuk jemi dakord!”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk janë në këtë ligj.

Ju lutem!

Rasti i deputetit, unë e kam pritur vetë në zyrë, nuk është rast që ka të bëjë me ligjin.

Eduard Shalsi - A ka mundësi!

A i ezaurojmë dot sipas radhës, dakord?

1. Në lidhje me 10-20%-shin.
2. Pyetjet e zotit Sinaj.

Artan Lame – Logjika për këto raste ekstreme duhet të jetë në parim: regjistrohet AMTP-ja, atij që ka zënë 5 hektarë do t'i regjistrohet sa i takojnë me ligj, maksimumi plus 20%-shin. Pjesa tjetër është çështje e policisë. Kjo e fundit duhet të shkojë dhe t'i thotë: “Vëlla i dashur hap krahun, sepse nuk është toka jotet!”. Nuk po e shmang përgjegjësinë, por nuk ka sens se çfarë të themi më tepër.

Vullnet Sinaj - Është një fshat që e përmenda unë, i cili 5 hasmëri brenda tij. Ka 5 vrasje në atë fshat. Në të gjithë zonën që kam unë atje janë kryer 5 vrasje. Fshatarët, 40 familje që u kanë zaptuar tokën, këto 3 familjet e “të fortëve” do të vriten. Mos ia lini individit! Caktojani të drejtën agjencisë, që në raste të tilla zaptimi të jetë ajo, e cila të ndërmarrë hapat për t'i çuar zaptuesit në prokurori. Kaq kërkojmë.

Eduard Shalsi – Po, zoti Lame.

Artan Lame - Jam shumë dakord që të shikojmë një mënyrë sesi do të orientohejmë drejt policisë, por është realisht problem policor, jo problem ligjor.

Vullnet Sinaj- Po të përmend edhe diçka, te këto 40 familje ke të gjitha problemet e tjera: AMTP-në që nuk korrespondon me tokën, AMTP-në më të vogël. Pa zgjidhur që t'u shkojë toka këtyre, nuk zgjidhen dot problemet e tjera.

Eduard Shalsi – E kam për përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, ky problemi që ngre zoti Sinaj, a është masiv në Shqipëri? A ka fshatra që janë pengje të 2-5 familjeve?

Majlinda Bozgo - Ka shumë, në Ndoq, kemi në Tiranë, në Vaqar. Kemi edhe raste të tilla: ka zënë i pari që është në parcelë rrugën e kalimit dhe asnjë nuk e përdor dot tokën.

Eduard Shalsi – Atëherë, është një problem që nuk ekziston vetëm në këtë fshat. Zoti Lame, duhet ta mbani shënim se çfarë lloj zgjidhjeje mund t'i japim me polici, pa polici.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doja të kuptoja, nëse është fenomen i izoluar vetëm në një fshat apo është në shumë fshatra? Atëherë, duhet të adresohet institucionalisht, si, qysh, tek.

Vullnet Sinaj – Problemi i dytë, është se nuk kanë tokë fare. Nuk mund të lihen pa i përmendur këta. Do t'i jepet një zgjidhje, nga tokat që dalin tepër, a nuk e di, por duhet të përmenden.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - ... në raste ekstreme.....dikush ka thënë: “ Unë nuk kam AMTP-në”.....më takonte tokë, por nuk më kanë dhënë tokën me AMTP. Toka ishte ndarë. Nuk kishte më vend se ku të merrte dhe ai ka shkuar në gjykatë. Ka vendime gjykate që thonë: “ I takon 1,5 hektarë tokë, Të pajiset me tokë!”.

Ata kanë mbetur kështu se nuk ka më tokë, apo jo?

Vullnet Sinaj - Nuk është ky rasti.

Artan Lame – Jo, nuk më kuptove. Në momentin që nuk ka mbetur tokë, pra është ndarë, nuk kemi ku ta gjejmë.

Vullnet Sinaj – Nuk është ky rast që e ka marrë me vendim gjykate, e ka marrë tokën kur është ndarë.

Artan Lame - Problemi është se nuk ka mbetur më tokë.

Vullnet Sinaj- Është ndarë toka, paguan taksat, ka AMTP-në në dorë, tokën e ka marrë lumi. Nuk ka tokë fare. Duhet t'u japim tokën.

Artan Lame - Ku ta gjejmë tokën?

Vullnet Sinaj- Merreni nga ajo që del tepër.

(Diskutime pa mikrofon)

Mos i shpërbleni! Të gjendet një zgjidhje!

Artan Lame- Ajo është çështje e Ministrisë së Financave. A do të fusin konceptin që i takonte tokë dhe ia ka marrë lumi?

(Diskutime pa mikrofon)

Në nivel sipërfaqeje si problem ta themi fare hapur, midis kolegësh ky problem ndihet në Veri, që do të thotë se ata kanë marrë shumë më tepër sesa u takon. Pse? Sepse pretendojnë se e kanë të vjetër, veçanërisht në zonën e Koplikut, Malësisë së Madhe, që do të thotë, atij i takonte 1 hektarë dhe ka zënë 3 hektarë, por nuk i hyn njeri tek ato 3 hektarë, e dinë ata me njëri-tjetrin : “ Kjo është toka e babës”. Në Komisionin e Kthimit të Pronave nuk shkon, nuk e di se nga bie dera. Nuk u hyn njeri atje dhe nuk e fakton dot. Ai nuk do t’ia dijë se çfarë është Komisioni për Kthimin e Pronave: “Këtu jam unë!” dhe gjendemi në këtë situatë. Me këtë ligj ne shikojmë deri te ky limit. Unë them se edhe fare nuk mund ta hapim, pasi nuk mund të themi: që kjo do të zbatohet vetëm në Veri. Kam frikë se i hapim rrugë edhe abuzimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pastaj, do të ishte problemi tjetër, a janë plotësuar të tjerët? Kjo që ka mbetur shumë tokë, do të thotë se nuk kanë marrë të tjerët.

Majlinda Bozgo – Do të ndodhemi edhe përballë faktit që do të shkojmë, do të japim 10-20%-shin, por ndërkohë mund të biem në pronën e dikujt tjetër, i cili e ka marrë AMTP-në dhe rikthehemi në rastin që....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo ata kthehen, sepse rasti....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Matjet e gabuara.

Prandaj është lënë 10%-shi.10%-shi në ligjin aktual parashikon gabimin në momentin e ndarjes nga komisioni.

Më falni? Për qartësi, për sipërfaqe shtetërore është në nenin 9, pika 1, germa “a”? Flitet vetëm për sipërfaqe shtetërore, sepse po bëjmë një debat që nuk ka të bëjë me sipërfaqet private.

(Zoti Ilir Beqaj flet pa mikrofon)

Majlinda Bozgo - Ato mund të përcaktohen edhe me VKM më pas.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Zoti Beqaj, e sqarove 10-20%-shin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo - Më falni! Kam një gjë të fundit: ndarja që kemi pasur ka qenë e qartë. Ne jemi për formalizimin e marrëdhënies së përdoruesit të tokës me atë që ka tokën dhe jo për legalizim të një zaptuesi ose për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Artan Lame – E para, nuk është legalizim.

E dyta, nuk është zaptues, sepse ti, si shtet, ia ke bërë gabim matjet në vitin 1991.

Grua – Jo, 20%-shi nuk është gabim matjeje, madje edhe 10% mund të mos jetë gabim matjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Flisni me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Në qoftë se është sipërfaqe që i takon, nuk është fare zaptues. Zaptim është kur shkon atje dhe e merr, siç thotë ai, gjithë fshatin. Në qoftë se kjo ka qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky këtu. Jam zgjeruar për sa kohë nuk kam pasur asnjë lloj...

Kujt ia kam zaptuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Askush.

(Diskutime në sallë)

Do të thotë se është gabim në llogaritje.

Lorena Goxhobelli – Këtu flitet vetëm për pronësi shtetërore, jo për pronësi të tretë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ne po flasim për copëza, që janë krijuar nëpër parcela dhe sot nuk i ka njeri tjetër. Ai e ka kufitare. E përdor? Ta gëzojë, mor vëlla!

(Diskutime në sallë)

Ilir Beqaj – Unë do të doja që ato dy koncepte, që ju i keni shtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ka ligji për servitutet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht si nocione.

(Diskutime në sallë)

Artan Lame – Gjithnjë tentoj që ta kthej nga një proces bujqësor, agronomik e të tjerë, në një proces topografik dhe urbanistik në fshat. Kjo do të thotë se Gjinali, që u rregullua, u rregullua duke pasur pa diskutim dhe po ta shihni...

(Kakofoni në sallë)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Si zgjidhet sot? Sepse kur ne shkojmë ta bëjmë këtë partneritet kudo, lëshohet nga ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një pyetje që më lindi tani: sa zgjat procesi në të gjithë Shqipërinë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Është e hapur ndaj çdolloj procesi: qiradhënie, marrje, sepse iu nënshtrua një procesi, i cili...

Ilir Beqaj – Sa zgjat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se kjo punë nuk është bërë, ngrihen DCP-të, apo vazhdojnë historitë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Informalët jo, sepse nuk janë regjistruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Po flasim për gjënë më të rëndësishme.

Eduard Shalsi – Sipas opinionit tonë.

(Diskutime në sallë)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Sigurisht, këtu ka zona zhvillimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Në fazën e parë, edhe me bashkëpunimin e qeverisë, ka një përzgjedhje të të tria zonave ku do të fokusohemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo thjesht pilote.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Pellgu i Fierit.

Ilir Beqaj – Myzeqeja, Nënshkodra e të tjerë, që janë zona kryesore bujqësore.

Majlinda Bozgo – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – ...i Veriut dhe Vlora. Kjo do të thotë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa zgjati kjo këtu? Zgjati nja gjashtë muaj apo një vit. Pse? Sepse iu nënshtrua të gjitha gjetjeve të sotme. Sa të takonte, si e bëre...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke bërë bilancin e të gjithës, por ne e heqim konceptin e bilancit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që të bësh bilancin e të gjithës nuk mbaron asnjëherë.

Ilir Beqaj – A mundem, zoti kryetar, sepse kam një pyetje shumë të rëndësishme parimore?

Eduard Shalsi – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë tani, se ka edhe dy pika proceduralisht!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe dy pika nga Ministria e Bujqësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Merri leje atij, jo mua!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Kishit diçka procedurale?

Ilir Beqaj – Parimore, jo procedurale.

Eduard Shalsi – Ndizeni mikrofonin, që t'ju dëgjojmë.

Ilir Beqaj – Tani, unë dua vëmendjen e komisionit dhe predispozitën e të ftuarve për të më dhënë një zgjidhje nëse ka zgjidhje këtu.

E kemi diskutuar dhe unë e kam pasur shumë merak në korrik kur kaluam paketën fiskale në lidhje me tokën bujqësore. Ne duhet t'i vëmë një kufi copëzimit të tokës bujqësore, sidomos për efekt trashëgimie.

Te këto që kemi e zgjidhim, sepse i bëjmë vetë amendamentet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se e zgjidhim, na i jepni ne si amendamente, sepse, për shembull, Italia e ka 7 hektarë, por më pak se 7 hektarë nuk e copëzon dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në kohën e Zogut ishte kështu: tokën e trashëgonte vetëm çuni i madh ose çuni i gocës së madhe. Pra, nuk ndahej toka mbi 1 hektarë në tresh, se pastaj do të bëhej çika-çika dhe do të mbaronte toka bujqësore në Shqipëri.

Artan Lame – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Këtë shqetësim kam.

Artan Lame – Ja, ju lutem!

Çështja e konsolidimit...

Ilir Beqaj – Më falni, një sekondë, se tani erdhën ligjet! Këto ligje vijnë pas nja pesë vjetësh..

Artan Lame – Jo, të lutem!

Eduard Shalsi – Ne e kemi diskutuar këtë çështje, e cila ka pasur një problem me Kodin Civil.

Artan Lame – Ja do ta them. Çështja e konsolidimit të tokës bujqësore është, pas çështjes së legalizimeve, një nga dashuritë e mia personale të mëdha.

Aktualisht, legjislacioni shqiptar ka jashtëzakonisht deficienca në këtë fushë, sepse nuk parashikon absolutisht asnjë dispozitë ndaluese. Ama një nga pesë komponentët me të cilët është marrë Komiteti i Tokës, bashkërisht me Majlindën, ka qenë pikërisht futja e një komponenti të konsolidimit.

Jo më larg se sot paradite diskutuam për çështjen e ekspertizës së Bankës Botërore dhe futëm një komponent të veçantë, marrjen e legjislacionit dhe ekspertizën vetëm për këtë gjë, pra për konsolidimin e tokës bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk fut dot gjë; asnjë element!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë! Dihet se realisht është një nga çështjet më të rëndësishme që i takon së ardhmes në Shqipëri.

Një gjë e fundit, që e diskutuam sot mbi bazën e disa vërejtjeve që kishte bërë zonja Gjermani, lidhet me barazinë gjinore e kështu me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I përfshimë, por, në mënyrë indirekte, edhe ajo ka të bëjë me konsolidimin e tokës, pra me pengimin e të gjitha ndarjeve dhe nëndarjeve të mëtejshme të tokës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e fut dot në këtë legjislacion.

Unë premtoj që, meqenëse sot u diskutua me Bankën Botërore për financimin e ardhshëm, dhe ne kemi futur një komponent më vete vetëm për marrjen e legjislacionit ndërkombëtar të konsolidimit të tokës, sepse jam personalisht partizan dhe ndjekës i kësaj çështjeje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...në momentin e parë që do të më jepet mundësia, do të raportoj se deri ku mund të shkojmë.

Eduard Shalsi – Lorena, ke edhe dy pika?

Lorena Goxhobelli – Po.

Para se të shkojmë te dy pikat, është diferenca mbi 20%. Çfarë do të bëjë? Ministria e Bujqësisë thotë: “dhënie me qira”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por është e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë bëhet me diferencën, e cila evidentohet mbi 10% ose 20%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Ilir Beqaj – Nuk e ndamë ende nëse është 10% ose 20%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Si nuk e ndamë? Çfarë bëre deri tani?

(Ilaritet në sallë)

Robert Bitri – A mund të bëj një pyetje meqenëse këtu kemi përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Prit, se nuk e kemi ndarë 10% apo 20%!

(Deputeti Bitri flet pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Një sekondë, që ta ndajmë pak se çfarë do të bëhet me 10%-shin/20%-shin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, çfarë thotë Ministria e Bujqësisë?

Lorena Goxhobelli – 10% themi ne.

Eduard Shalsi – Ndërkohë që ne jemi për 20%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – 20% thatë ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ju lutem, të flasim një nga një!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Jo, është pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

20% është i falur.

(Deputetët flasin pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Dakord, 20%.

Lorena Goxhobelli – A ta citoj siç e ka neni? Thuhet: “Sipas projektligjit që kemi, deri në 20% sipërfaqe shtetërore kalohet në pronësi sipas çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës” dhe nuk ka asnjë përcaktim tjetër për shitjen mbi 20%, por thuhet se kalon në fondin e tokës dhe jepet në përdorim.

Ilir Beqaj – Me lekë është që te metri i parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Shikoni për çfarë ka rrezik ajo, se mund të jetë sipërfaqe e madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka kufizim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ju lutem!

Ilir Beqaj – A thatë që nuk ka më shumë se 2 hektarë?

Majlinda Bozgo – Nuk po flasim për AMTP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë, tani!

Zoti Beqaj, ndizni mikrofonin sa herë keni ndonjë gjë për të thënë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në fund, ju lutem, flisni një nga një!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Si Fusha e Korçës, si Devolli...

(Debat në sallë)

Ilir Beqaj – Nuk e dua të vijë. Unë dua fermë të madhe, unë nuk i jap financim fermës së vogël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Zoti Beqaj, ju lutem, nuk ka 2 hektarë bashkë gjëkund!

Ju e patë që parcelat ishin të copëzuara. Parcelat janë nga 3-4 mijë metra, që do të thotë se ai nuk mund të marrë më shumë se 600-700 metra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

Ilir Beqaj – 1 hektarë e kam timen.

Artan Lame – E keni me AMTP?

Ilir Beqaj – Jo, e kam blerë.

Artan Lame – Në një vend ishte, apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, paska qenë rast i veçantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Ndërsa unë e kam të ndarë.

Artan Lame – Po pra, por nuk merr dot më shumë se 1000-2000 metra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Po flasim për 20% mbi AMTP, jo mbi ngastër. Pra, AMTP-ja mund të jetë më shumë.

Ilir Beqaj (off) – AMTP-ja nuk ka qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Mesatarisht...

Majlinda Bozgo – 15000-20000...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Mesatarja nuk është 20000, është më e lartë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – 1,2 është në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Në rregull.

Lorena...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Si ka mundësi?

Eduard Shalsi – 10000 thonë për Vorën.

(Deputeti Beqaj vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Majlinda Bozgo – Po, për frymë.

Fshati ka pak banorë dhe shumë sipërfaqe toke.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Vora?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Nuk ka parcela të mëdha të mbetura, janë këto rripat.

Mos e humbisni fokusin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Lorena, më ndiq pak tani!

Besnik Baraj – Kam një pyetje parimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Në fakt, ka dy pyetje, por tani të mbarojë pak Lorena dhe pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe sa pika kanë ngelur?

Lorena Goxhobelli – Edhe pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Dy pika më the qeparë.

Lorena Goxhobelli – Nuk lëvizim nga dy pika.

Eduard Shalsi – Vazhdo, Lorena.

Lorena Goxhobelli – Atëherë, në nenin 10 ka vetëm një korrigjim të vogël, sepse nuk e kanë paraqitur saktë formulimin e pikës 1 të germës “a”. Është propozim i Braçes, se po i rikthehem, por nuk e kanë vendosur që ata kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve. Domethënë, që të konsideroheshë subjekt i ligjit duhet të ishte punonjës, por edhe banor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E sqarova pjesën, se ata kanë qenë banorë faktikisht, por gjendja civile...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk bie ndesh fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, duhet një riformulim për t’u qartësuar se flasim për ata persona, të cilët kanë qenë edhe punonjës të ndërmarrjes bujqësore, edhe banorë faktikisht. Kemi bërë një riformulim, të cilin e kemi edhe në...

Eduard Shalsi – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Depozitoje.

Keni ndonjë gjë për këtë pikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni ndërhyrjen për këtë pikë?

Po, për pikën 1 të nenit 10. Çfarë do të ndodhë me ata që e kanë marrë tokën, por nuk kanë marrë ende aktin e marrjes së tokës në përdorim?

Lorena Goxhobelli – U plotësohet AMTP-ja e atyre personave të cilët janë përdorues faktikë, pavarësisht nëse kanë ose jo akt përdorimi. Kjo bëhet aktualisht edhe me legjislacionin që kemi në fuqi, por parashikohet edhe në nenin 10 të këtij projektligji.

Eduard Shalsi – Në rregull.

Lorena Goxhobelli – Te neni 11...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe diçka këtu, se ishte merak. Nuk është përcaktuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Cili nen dhe cila pikë ishte?

Lorena Goxhobelli – Germa “a” e pikës 1 të nenit 10 është riformulim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E zgjidh, por...

Kjo është për atë fashë, por nuk është jopunonjës.

Edhe diçka në kriteret ndaluese, që nuk kalon toka në pronësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pika 2 tek i njëjti nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk është vendosur si kriter përjashtues rasti i tokave që janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë të cilat janë për destinacion qiradhënien.

Mund të ndodhë që unë sot aktualisht kam kërkesa nga subjekte private dhe i kam në proces për qiradhënie...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ngriji disa muaj, sepse në 25 vjet nuk ua kemi parë hairin tokave bujqësore që ka dhënë Ministria e Bujqësisë.

Besnik Baraj – Një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, lejojeni një minutë se ka dalë te pyetja ime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam marrë 80 mijë metra katrorë me qira, e kam bërë me kontratë me ministrinë tuaj dhe është regjistruar në ZRPP e të gjitha. Tani dua të aplikoj për IPARD-in. Por kur shkoj të

aplikoj, më thonë: “Ti nuk ke të drejtë të aplikosh, sepse ti nuk e ke me tapi”. Zgjidheni këtë, pasi keni shumë...!

Robert Bitri – Nuk është e vërtetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

IPARD-i nuk e pengon këtë pjesë, pyet edhe kryetarin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Ore, nuk e përcjell ministria!

Robert Bitri – Zgjidhe tek IPARD-i, pyet kryetarin. Mjafton të kesh marrëdhënie qiraje dhe tek IPARD-i shkon, apo jo, zoti kryetar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Nuk ka certifikatë pronësie, mor!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një nga një, ju lutem!

Besnik Baraj – Prit, ore zotëri! Ti ngrite gjëra në parim, që nuk kanë të bëjnë me ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ma tha juristja, se nuk ka lidhje me ligjin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky problem është, zoti Sinaj, atje në Përmet, ku ai investitori shumë serioz ka aplikuar vitin e kaluar dhe për këtë arsye e kanë refuzuar. Tani ai dëshiron të aplikojë, po e ngre këtë problem kudo, po troket në hipotekë e gjetkë, por nuk i japin përgjigje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Stop!

Ai ka aplikuar vitin e kaluar, por vjet nuk ka pasur IPARD...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Vetë Ministria e Bujqësisë e ka pasur si kriter.

Eduard Shalsi – Të lutem, ta mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje, ai ka shansin tani ta shndërrojë edhe në det.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se zoti Baraj shtroi një shqetësim!

Në rastin konkret, ka marrë tokën me qira dhe do të aplikojë për fonde, por nuk legjitimohet për sa kohë nuk është pronar i truallit.

Në bazë të fondeve që Ministria e Bujqësisë kishte destinuar vitin e kaluar, kushti ishte edhe pasja e certifikatës së pronësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtrohet pyetja, dhe këtu sqaroni me dy fjalë zotin Baraj: për të aplikuar te paketat e IPARD-it është e domosdoshme certifikata e pronësisë, apo jo? Nëse ka një përgjigje, në rregull. Në qoftë se jo, të lutem, nesër na sillni një përgjigje. Kaq e thjeshtë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë po thosha. Vazhdoni.

Majlinda Bozgo – Nisur nga njohuritë e mia, kontratat e qirasë regjistrohen dhe Zyra e Regjistrimit është e detyruar të lëshojë certifikatën e qirasë. Me marrjen e certifikatës, të gjithë aplikojnë për përfitimin nga skemat mbështetëse.

Eduard Shalsi – Zonja Majlinda, pyetja është konkrete. Në datën 30 janë hapur thirrjet për IPARD dhe do të përfundojnë në datën 31 janar. Subjektet legjitimohen, apo jo? Kaq.

Vazhdojmë me të tjerat.

Majlinda Bozgo – Po, legjitimohen.

Eduard Shalsi – Për IPARD-in?

Majlinda Bozgo – Po, me certifikatë qiraje.

Eduard Shalsi – Mbajeni shënim, zoti Baraj, dhe e pyesim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, e korrigjojmë atë. Vazhdojmë me pikën tjetër.

Artan Lame – Edhe pika tjetër ka qenë nga ato pika për të cilat jemi kundër në botëkuptimin me Ministrinë e Bujqësisë, çka do të thotë se... Madje të mos harrojmë që merremi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këtë që po flisnit.

Atëherë, ku qëndron dallimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ministria e Bujqësisë thotë: tokat që janë të sajat të mos përfshihen në këtë proces, në një kohë kur, në qoftë se subjekti ka marrë AMTP dhe është përdorues faktik i asaj toke nuk ka sens që ne t'i hyjmë dhe t'i themi “Jo, sepse është tokë e Ministrisë së Bujqësisë”. Ne kemi përjashtuar nga ky proces vetëm tokat që janë në administrim të institucioneve kërkimore-shkencore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka sens, sepse është e Institutit të Bujqësisë, është e Universitetit e të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka sens që toka, të cilën ai e ka marrë dhe e përdor...

Ku është problemi tani? Është e vërtetë kur Ministria e Bujqësisë thotë se ka dhënë me qira nga këto toka, të cilat ishin ndarë. Normalisht, nuk duhet ta jepte me qira një tokë që ishte ndarë me AMTP. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak se një pjesë e dhënieve me qira bëhej pa verifikuar në terren se çfarë ndodhte apo pa ndjekur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli – Më falni, sepse ka një konfuzion!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Ai e ka AMTP-në dhe kjo prevalon...

Lorena Goxhobelli – Jo, jo!

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Ju lutem, flisni një nga një!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Ai e ka marrë.

Lorena Goxhobelli – Ka një konfuzion. Ne nuk po flasim për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Ky është opinionimi ynë dhe do të thotë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj, cila është zgjidhja tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai e ka marrë përpara me AMTP, pra pasi është bërë ndarja.

Lorena Goxhobelli – Po bëjmë një debat që nuk ekziston.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Do të flasësh edhe ti? Do të flisni të gjithë paralelisht?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë pra!

Po, zonja Goxhobelli.

Lorena Goxhobelli – Po bëjmë një debat që, në fakt, nuk ekziston, sepse nuk po flasim për rastet kur ka një titull pronësie. Kjo nuk është absolute, por po flasim për rastet kur nuk ka një titull pronësie dhe do t'i plotësohet një i tillë.

Sugjerimi ynë ishte që nuk duhet të plotësohet titull pronësie kur toka është në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe është destinuar për qiradhënie.

Kjo ishte thjesht për ta sqaruar.

Eduard Shalsi – Opinioni...

Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Një sekondë, Lame!

Edvin Kukunja – Në lidhje me qiratë ekzistuese ne e kemi respektuar këtë kriter kur kemi thënë:” të mos jetë dhënë në përdorim apo me qira të tretëve;” pra nuk i cenojmë të drejtat e qirasë apo të përdorimit që ekzistojnë. Ne nuk i japim në këto raste, por për ato që nuk janë dhënë ende me qira dhe që janë në përgjegjësi dhe në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, gjykojmë se prevalon e drejta e subjektit të ligjit, që e përdor për më shumë, faktikisht për ta përfituar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – E qartë.

Urdhëro, Beqaj!

Ilir Beqaj – Po flasim për sipërfaqe relativisht të vogla, për një kontratë qiraje zhvillimi. Ministrisë së Bujqësisë nuk ka mbetur të japë çika-çika nga 4-5 ha. Ne na duhet t'i japim 50 ha një subjekti. Këto pjesët e vogla le t'i marrë ai që është në kufi me to dhe le t'i zhvillojë.

Lorena Goxhobelli – Komenti tjetër ka të bëjë me nenin 11.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Bëji në seancë komentet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bravo! E qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Lorena Goxhobelli – Komenti tjetër ka të bëjë me nenin 11, i cili përcakton sipërfaqet që caktohen për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës. Flasim për rastet e përdoruesve faktikë, të cilët nuk janë pajisur me tituj pronësie. Sugjerojmë (kjo është parimore), që në plotësimin e AMTP-ve të reja të respektohet koncepti i normës për frymë në të cilin janë trajtuar subjektet e tjera brenda të njëjtit fshat. Sipas VKM-së nr. 255 datë 2.8.1991, e cila e përkufizon normën për frymë si raport i sipërfaqes së tokës bujqësore të vënë për ndarje sipas regjistrit kadastral më datë 1.8.1991 me numrin e frymëve të fshatit sipas regjistrit të gjendjes civile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në çfarë kuptimi në Veri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Veri dhe në të gjithë Shqipërinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po flasim për AMTP-të ekzistuese. Neni 11 thotë: “Sasia e sipërfaqes të tokës bujqësore që kalohet në pronësi pa shpërblim është sa sipërfaqja që përdoret faktikisht, sa sipërfaqja e tokës në përdorim, por në çdo rast jo më shumë se norma për frymë e zbatuar. Pra, koncepti i normës për frymë është edhe në këtë nen. I vetmi devijim që ka këtu është në rastin e akteve të marrjes së tokës në përdorim.

Ne i qëndrojmë parimit që duhet të respektohet koncepti i normës për frymë, sepse në fund të fundit vendos barazinë mes fshatarëve në të njëjtin fshat. Nuk mund ta trajtosh njërin me më pak (të paktën për mundësinë që kemi për këta që po plotësojmë sot). Kemi bërë lëshim për AMTP-të ekzistuese për vetë faktin që duhet t’i atakojmë në gjykatë dhe patjetër që këto procedura zgjasin deri në 3 vjet. Kemi rënë dakord që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Respektimi i konceptit të normës për frymë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ata që plotësohen sot, jo për ata...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po si do t'ia japësh sot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ia ke dhënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edvin Kukunja – Edhe fakti që e krijon përsëri dokumentacionin nga fillimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lorena Goxhobelli - Zoti Lame ju jep edhe më pak me parashikim, sepse projektligji thotë që norma për frymë llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së lirë të tokës (e pazënë nga tituj të tjerë)...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Mendoj të hiqet ky paragraf, pra pjesa e dytë e germës “b” të pikës 1 të nenit 11.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shprehja se çfarë është norma për frymë, sepse këtu nuk është e saktë. Ligji thotë se norma për frymë llogaritet duke u nisur nga sipërfaqja e lirë në terren, që përmbush kushtet e pikës 2, të nenit 10, të këtij ligji. Pra, e ndërlikon akoma më shumë dhe nuk është reale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Norma për frymë është e shkruar në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, te projektligji. Neni 11, pika 1, germa “b”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me çfarë e llogarit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, gjendja faktike që ke në terren, kundrejt kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Si do t'ua ndajmë fshatarëve sipërfaqet e lira që mbeten pas gjithë procesit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edvin Kukunja - Kërkoj ndjesë për keqkuptimin e krijuar!

Sikurse del nga dispozita, ne nuk e kemi marrë parasysh konceptin e normës për frymë sipas ligjit nr. 7501. Domethënë, norma për frymë nuk është si raport i sipërfaqes totale të të

gjithë kooperativës. U nisëm thjesht nga ideja që toka që do të kalojë në pronësi duhet të përmbushë disa kritere, të mos jetë pronë e të tretëve, të mos ketë qira dhe kushtet që listuam më parë. Pra, do të trajtojmë atë që e quajmë tokë të lirë. Të gjitha veprimet (ndarja dhe kalimi i pronësisë) bazohen mbi atë tokë, e cila siç është duhet t'u ndahet poseduesve, sepse ata e përdorin dhe shtetit nuk i duhet kjo tokë. Për pasojë, ky fond i lirë toke do të ndahet përpjesëtimisht për të gjithë përdoruesit faktikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Mendoj të hiqet përkufizimi se çfarë është norma për frymë, që është në ligj, sepse ka një gjë shumë thelbësore. Sot nuk ndahet tokë. Këtë duhet ta kenë të gjithë të qartë. Ne sot nuk po ndajmë tokën. Sot po plotësohen titujt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – E qartë.

Atëherë, propozimi i Ildës është: pse duhet të jetë norma për frymë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edvin Kukunja – Ndjesë!

Atëherë, t'u kthehemi kushteve dhe premisave për të cilat po flasim. Po flasim për një person, që ka qenë subjekt i ligjeve të kohës me rregullimet specifike që parashikuam dhe që e përdor faktikisht tokën për qëllime bujqësore, siç e kërkon ligji. Në këtë pikëpamje, nuk shoh arsye pse mos t'i ndahet toka që ai po përdor për të cilën është i legjitimuar të përfitojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë!

Për mungesë të një termi më të mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Pse duhet të jetë norma për frymë? Kjo është pyetja, që po bëhet në rastin konkret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Ose do të marrë aq tokë sa ka, ose do të marrë sipas normës për frymë. Po është norma për frymë, do të marrë sipas normës për frymë ...

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Norma për frymë ishte një koncept atëherë, kur ndahej toka. Tani nuk ka se çfarë të ndahet, se tani jemi te fakti dhe pyetja që bëhet është, nëse duhet të jetë apo nuk duhet të jetë. A ka një përgjigje për këtë?

Edvin Kukunja – E gjithë sipërfaqja që llogaritet për t’u kaluar në pronësi në total është ajo, që ne e quajmë sipërfaqe e lirë. Ajo që do të kalohet në pronësi është aq sa përdor faktikisht, por jo më shumë se norma për frymë në kuptimin, që nëse kjo sipërfaqe e lirë nuk ka barrë, nuk ka të drejta të të tretëve që rëndojnë mbi të...

Eduard Shalsi – Ma shpjego më thjeshtë, se nuk e kuptoj! Nëse është apo nuk është norma për frymë, ç’farë difference ka, se unë nuk e kuptoj?

Edvin Kukunja – Norma për frymë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Kjo ka kuptimin në rastin kur posedon 10 ha dhe duhet të marrë 2 ha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ç’kuptim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Ka një përkufizim të normës për frymë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edvin Kukunja – Dakord. Për mungesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mungesë të një termi më të mirë, e kemi quajtur normë për frymë. Ajo mund të cilësojë diçka tjetër, sepse është e ndryshme nga ajo normë që përdorej atëherë.

Eduard Shalsi – Këtë po thotë.

Majlinda Bozgo - Cili akt e përcakton normën për frymë? Ku do të referoheni ju për këtë term dhe cili është institucioni përgjegjës që do ta përcaktojë normën për frymë? A ma thua pak?

Edvin Kukunja – Ju kërkoj ndjesë nëse e kemi lënë, sepse kemi menduar sikur është nënkuptuar koncepti i normës për frymë! Norma për frymë e parashikuar në këtë projektligj llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së lirë të tokës, pjesëtuar me përdoruesit faktikë.

Majlinda Bozgo - Cili akt ligjor apo nënligjor e përcakton normën për frymë? Ku është?

Edvin Kukunja – Ne kemi tentuar që këtë rregull, këtë normë (nuk po e quajmë normë për frymë), ta vendosim në këtë dispozitë, ta krijojmë për efekt të barazisë. Në momentin kur nga ajo sipërfaqe e lirë dikush ka zënë më shumë sesa ç’i takon të ketë përpjesëtimisht, nuk do të marrë më tepër se aq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Menduar ta fusim parimin e barazisë tek kjo tokë, që po ndahet sot.

Eduard Shalsi – Premisa nga të cilat jeni nisur ju është e drejtë. Kur të vini te pjesa e aplikimit, nuk do të dini se ku të referoheni, prandaj mendoj të bëni ndonjë riformulim.

Majlinda Bozgo – Më falni!

Kam një koment. Ne bëmë një diskutim të gjatë për normën për frymë plotësohet nga AMTP aq sa i takonte, mbi 20% shitet, mbi 20% futet në fondin e tokës që jepet me qira apo për përdorim dhe i jepet kufitarit.

Tani po rikthehem. Si do ta plotësojmë titullin e pronësisë? Ideja është që ky proces është nëpërmjet një procesi të nisur që në vitin 1991. Pra, ne nuk po ndajmë tokë, por po u plotësojmë dokumentet atyre personave, që nuk e kanë marrë dokumentacionin dhe janë përdorues të tokës që u është ndarë. Zgjidhja është shumë e thjeshtë: të marrin aq sa posedon, por jo më shumë se norma për frymë. Norma për frymë është sipas ligjit nr. 7501, por duhet pasur parasysh që ky projektligj te përkufizimet, ka edhe aktet ligjore dhe nënligjore të kohës dhe u referohet në fakt atyre, nuk është se i referohet. Në nenin 2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se e lëmë thjesht aq sa posedon, pastaj do të bëhet një amulli e vërtetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një e nga një.

Ilir Beqaj – Problemi është ky: duhet të sqarojmë diçka, sepse në fund të pikës 1 duhet të bëjmë një tentativë për ta përkufizuar. Këtu po tentojmë për të përkufizuar diçka të re.

Majlinda Bozgo – Ne jemi për ta përcaktuar normën për frymë që i është referuar legjislacionit të kohës, sepse ne nuk po e ndajmë tokën sot, por po plotësojmë dokumentacionin për ata që e kanë marrë. Pra, ne themi: aq sa posedon, por jo më shumë sesa norma për frymë.

Ilir Beqaj – Duhet të shprehemi te përkufizimet apo këtu, sipas përkufizimit të atij ligji.

Unë kam një pyetje formale: Kur ky akt të miratohet dhe të bjerë në fuqi, a do të ndërrohen më përkufizimet e atij?

Majlinda Bozgo – Jo.

Ilir Beqaj – Nga njëra anë duhet t'i referohemi atij ligji, por nëse ne e shuajmë atë, atëherë ose duhet formalisht ndonjë VKM e re ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Te përkufizimet termin “normë për frymë” ose përcaktoje sipas...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi pse të themi sipas ligjit nr. 7501. Që t'i referohesh tamam kësaj që ne jemi duke hequr këtu, do të duhet tamam një normë për frymë. Ai mund të ketë zaptuar hektarë të tërë dhe s'ka pse t'i marrë ato pa shpërblim, meqë i posedon. Nuk ka logjikë t'i marrë pa shpërblim meqë i posedon. Nëse i posedon, le t'i blejë.

Ose mund të kemi ndonjë rast, sipas shembullit të Vullnetit që 3 veta kanë marrë të gjithë tokën e fshatit dhe meqë e posedojnë ata, le ta gëzojnë.

Klotilda Bushka – Unë kam një diskutim edhe juridik, edhe politik.

Atyre, të cilëve ne u kemi dhënë aktin e marrjes së tokës në përdorim dhe më pas atë të marrjes së tokës në pronësi, u themi: në qoftë toka, të cilën ti sot e ke ka pasur $x \text{ m}^2$ sipërfaqe dhe sot të del $x+2 \text{ m}^2$. Këtë dyshin mbi sipërfaqen, do ta paguash. Ky është rregulli?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë! Po, deri në një tavan. Këtyre, të cilët nuk kanë asnjë titull, por e përdorin faktikisht, u themi: me normën për frymë. Këtu është pabarazia.

Artan Lame – Nuk është pabarazi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Pabarazi është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë sa ta mbaroj!

Unë them ose do të përdorim të njëjtin model dhe të themi se do të përdorim normën për frymë dhe themi, se kjo normë për frymë duhet të parashikohet në ligj: “Norma për frymë duhet të përcaktohet nga...” Nuk ka nevojë të vihet si përkufizim, por mund të vihet si pikë 3 e këtij neni: “Norma për frymë e parashikuar në këtë projektligj llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së lirë të tokës, pjesëtuar me numrin e banorëve.”

Them: norma për frymë e llogaritur në këtë mënyrë na përcakton se një banor i këtij fshati merr x metër katror. Për çdo sipërfaqe tepër, mund të veprojmë ashtu siç kemi vepruar me ata që kanë titull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë!

Po ju jap dy versione, ose do t’ua japim siç ua kemi dhënë atyre që kanë titullin deri në një nivel, ose për mendimin tim, do ta heqësh fare frymën dhe do t’u lësh të gëzojnë aq sa kanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë!

Unë po t’ju jap dy sugjerime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në kuadër të këtyre dy sugjerimeve, në qoftë se do të vendosim për normë për frymë, nuk ka nevojë të bëjmë përkufizim, duke iu referuar legjislacionit të mëparshëm. Përkufizimi i normës për frymë të jetë ashtu siç e gjykuam këtu: sipërfaqja e lirë e tokës, pjesëtuar me numrin e përdoruesve. Kaq.

Ilir Beqaj – Kemi raste konkrete të kësaj natyre: e ka marrë me letra tokën, ka filluar ta përdorë dhe tani që është bërë azhurnimi, del që ka pasur më tepër, sepse i ka dhënë më tepër shteti. Pasi e ka përdorur duhet të kthehet te kufiri i vjetër dhe sot i jepet mundësia që po të dojë, ta blejë deri në një kufizim.

Ky tjetri nuk ka qenë fare pjesë e këtij procesi dhe për ta vlerësuar se kush është përmasa e problemit, këta te pika “b” janë shumë më pak se këta të pikës “a”. Këta të pikës “b” disa janë fakirë, por disa (shumica) janë zullumqarë.

Klotilda Bushka – Janë ata që kanë përfituar nga ndarja fshatçe.

Ilir Beqaj – Këta të pikës “a” do të kenë një avantazh, se ju folët politikisht dhe juridikisht. Këta të dytët të rrinë te fryma dhe nuk ka pse të shkojnë te 20-përqindëshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht, për të mos i trajtuar...

Klotilda Bushka – Pse i paragjykojmë këta të dytët, si zullumqarë?

Ilir Beqaj – Sepse kështu janë realisht dhe për momentin, janë pakicë. Ky është realiteti.

Klotilda Bushka – Kemi edhe statistika për këtë. Ka zona të tëra në vend, ku janë kanë përfituar nga ndarja fshatçe. Është Shkodra, Malësia e Madhe, që nuk janë zullumqarë. Ata janë viktima të padijenisë.

Ilir Beqaj – Jo, do të kthehemi te kufijtë e vjetër. Ata kanë bërë abuzim politik.

Klotilda Bushka – Ata nuk janë zullumqarë.

Robert Bitri – Nuk e kemi për ata, Klodi, por e kemi për ata që...

Klotilda Bushka – Si ata ka edhe të tjerë që e kanë bërë, sepse aq kanë ditur. I kanë ndarë fshatçe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk i paragjykoj dot, nëse janë apo nuk janë zullumqarë. Për mua ai, që nuk ka lidhje fare me fshatin dhe ka marrë tokën atje duke jetuar në qytet, le t'i hiqet fare.

Unë po flas në parim. Duhet patjetër t'i barazojmë.

Robert Bitri – Po një njeri që ka abuzuar me komisionin e tokës dhe ka marrë 3-fishin? Si do t'ia lësh?

Ilir Beqaj – Ai nuk e gëzon dot.

Klotilda Bushka – Ai që ka marrë 3-fishin? Vëri kufi si atij tjetrit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – E vumë kufirin ne.

Eduard Shalsi – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – AMTP-ja nënkupton që është ndarë me normën për frymë. Njësoj është trajtimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Majlinda Bozgo – Nuk është e njëjta gjë, sepse ata e kanë me titull pronësie dhe që ta zhbësh atë titull pronësie, duhet të shkosh në gjykatë. Ne kemi bërë debate pafund, sepse Ministria e Bujqësisë ka qenë e mendimit për ruajtjen e kriterit të normës për frymë qoftë për ata që e kanë me titull...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Të gjitha AMTP-të kanë normën për frymë, jo më shumë. Mund të kenë lëvizjet plus minus. Ne themi që do të regjistrojmë AMTP-në siç është dhënë me normën për frymë, ku çdo fshat, në varësi të sipërfaqes së tokës dhe numrit të banorëve, ka pasur normën e vet dhe është pjesa plus 20, plus 10 dhe bëhet diferenca. Këta të rinjtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Atëherë, kalojmë te votimi me rekomandim.

Po marrim ligjet me radhë. Kemi miratuar kadastrën dhe përfundojmë me procesin kalimtar të pronësisë. Kemi rënë dakord që do t'i miratojmë me rekomandimet për Komisionin e Ligjeve. Pra, do t'i miratojmë nenet siç kemi rënë dakord dhe do t'ia bashkëshoqërojmë me një numër rekomandimesh. Kalojmë te ligji për kadastrën.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ilir Beqaj – Te pika 1, “b”, unë sugjeroj që të mos thuhet: “Buxheti i shtetit, në mbështetje të politikave të Këshillit të Ministrave”, por “Në mbështetje të programit të qeverisë”, sepse politika e Këshillit të Ministrave është shumë *flu*.

Te germa “c”, “donacionet dhe kreditë”, po huatë? Ajo është kredi me interes 0, pse duhet t’ia përjashtosh vetes të drejtën e huasë?

Eduard Shalsi – Ku ndryshon huaja nga kredia?

Ilir Beqaj – Huaja është me interes 0.

Eduard Shalsi – Fjala “Hua” dhe “Kredi” janë sinonime.

Ilir Beqaj – Jo.

Lidhur me pikën 4, unë nuk jam dakord që fondin rezervë ta miratojë këshilli drejtues, por të miratohet nga qeveria.

Eduard Shalsi – Po bëj një sqarim. Fjalët “kredi” dhe “hua” janë i njëjti nocion, janë sinonime.

Ilir Beqaj – E sjellim nesër me fjalor në Komision të Ligjeve.

Eduard Shalsi – E kam të konfirmuar këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A jeni dakord me nenin, sipas propozimit të dytë të zotit Beqaj?

Dakord.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ilir Beqaj – Nuk e kuptoj pse duhet “Kabineti i Kryeministrit”, sepse për sa kohë kabineti cakton drejtorin, çfarë duhet një anëtar i kabinetit ta çojë në këshill?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse te drejtori ka disa kritere, te kabineti ka më shumë liri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kë çojnë në ministri është diçka tjetër, këtu është përfaqësia, del vendimi i qeverisë së kush shkon, pastaj financa çon dikë, ministria çon dikë...

Unë propozoj që në vend të fjalës: “Kryeministri” të jetë “Ministria përgjegjëse për Turizmin”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te pika 4, germa “b”, thuhet se i propozon ministrit përgjegjës për Financat miratimin e tarifave të shërbimit të agjencisë. Me sa di unë, te ligji i tarifave zakonisht tarifat propozohen me dy ministra, me ministrin e linjës dhe ministrin e Financave. A e keni ende Ministrinë e Drejtësisë ministri linje?

Valgent Duni - ...paluajtshme. Do të ketë një rol mbikëqyrës mbi bazën e të dhënave, por nuk është më ajo varësi që është sot.

Ilir Beqaj – Të kalojmë te germa “f”...

Më fal! Te germa “d” i thuhet Kryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë të raportojë, Kryeministrit për shkak të varësisë direkt dhe ministrit të Drejtësisë për shkak të rolit që ka.

Për mendimin tim, fondet rezervë vjetore duhet të jenë nën administrimin e Ministrisë së Financave dhe qeverisë, jo të këshillave drejtues, sepse fondet rezervë, që lihen aty, prekin përgjithësisht financat publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Para publike janë ato me vetëfinancim. Ky fond rezervë ndikon edhe në masën monetare në qarkullim edhe në elemente të tjera.

Valgent Duni – Fondi rezervë, zakonisht, mbledhet kur do të bësh investime të caktuara, por, po mblodhe lekë për fond rezervë dhe t’i shkojnë buxhetit të shtetit, harroje që ...

Ilir Beqaj – Jo, fondet rezervë nuk janë për investime, por për gjëra të parashikuara. Investimet parashikojini në buxhet, jo të mbani fond rezervë për investime, sepse nuk ka logjikë.

Eduard Shalsi – Në rastin konkret i ke për miratime dëmshpërblimesh.

Ilir Beqaj – Unë propozoj që këtë ta miratojë qeveria dhe jo këshilli.

Eduard Shalsi – Kush është dakord me propozimin zotit Beqaj? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. A ka diçka për të shtuar?

Ilir Beqaj – Po, kam unë diçka. Kryetar, do të lidhim nenin 9 me nenin 11, sepse te pika 2, germa “f” e nenit 9 thuhet: “Drejtori i propozon këshillit drejtues strukturën organike në nivelin e pagave”, ndërsa te neni 11/1 niveli i pagave përcaktohet me vendim të Këshilli të Ministrave. Unë propozoj që drejtori t’ia çojë direkt qeverisë.

Eduard Shalsi – Kush është dakord me propozimin e zotit Beqaj?

Ilir Beqaj – Unë po pyes, sepse ka kontradiktë këtu.

Eduard Shalsi- Jo, nuk ka kontradiktë.

Ilir Beqaj – A keni punuar ndonjëherë në institucion apo jo?

Eduard Shalsi- Patjetër, kam qenë titullar institucioni!

Ilir Beqaj – Vetëm titullar ke qenë.

Eduard Shalsi –Jo, kam qenë edhe punonjës. Aty ku thuhet: “Drejtori i propozon këshillit drejtues” nuk jam dakord, sepse këshilli drejtues mund të ketë objeksione, mund të mos ia miratojë dhe mund të propozojë ndryshime. Pra, vendimi i këshillit drejtues, po flitet për nivelin e pagave, pasi kalon në këshillin drejtues, i shkon për propozim Kryeministrit. Domethënë, nuk ia çon vendimin drejtori, sepse nesër mund të çohet këshilli mbikëqyrës, që ti i ke lënë të gjitha këto attribute, dhe të thotë: “Edhe strukturën, edhe organikën, edhe nivelin e pagave e ka drejtori?”. A jeni dakord me propozimin e zoti Beqaj?

Nuk miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Te neni 10 kemi të përcaktuar detyrat e zyrës vendore, ndërsa detyrat e njësive administrative nuk i kemi të përcaktuara.

Ilir Beqaj – Zyrat vendore janë thjesht shërbime direkte, domethënë i menaxhojnë sportelet. Kjo është thënë në një dispozitë tjetër.

Valgent Duni – Drejtoria vendore administron dhe i ka të gjitha...

Piramida do të jetë deri në nivelin e bashkive, por jo të njësive administrative.

Po, por detyrat e bashkisë nuk janë të përcaktuara, aty janë vetëm detyrat e drejtorit qendror.

Valgent Duni – Dy janë strukturat e varësisë: drejtoria, e cila kryen funksionet e plota të agjencisë në nivel vendor, menaxhon regjistrin dhe kryen veprimet e të tjera, dhe zyra, ajo që menaxhon shërbimin direkt ndaj qytetarit.

Ilir Beqaj – Duhet të jenë të shkruara detyrat, pasi nuk kemi asnjë detyrë të shkruar.

Valgent Duni – Zyrat vendore janë struktura në varësi të drejtorive dhe ngrihen pranë njësive administrative territoriale. Këto zyra kryejnë shërbime të drejtpërdrejta ndaj publikut. Drejtoria vendore është ajo...

Ilir Beqaj – Funksionet.

Eduard Shalsi – Në ligj nuk thuhet funksionet e zyrës.

Valgent Duni – Në drejtorinë qendrore ka.

“Shërbime të drejtpërdrejta ndaj publikut dhe subjekteve të interesuara”. Ajo e menaxhon sportelin. Ky është kuptimi.

Eduard Shalsi – Si e menaxhon sportelin? Duhet të jenë të shkruara, ashtu siç i ka drejtorja qendrore.

Valgent Duni – Ankesat e qytetarëve.

Eduard Shalsi - Teorikisht do të duhej që këtu të kishte një pikë, ku të thuhej se drejtorja qendrore bën ose detajon...

Valgent Duni – Unë mendoj se ata janë shumë të rëndësishëm, pasi ata do ta bëjnë punën dhe ata do të ndjekin të gjithë procedurën në terren.

Eduard Shalsi – Kam diçka për të shtuar. Ne nuk mund të përcaktojmë në ligj se çfarë do të bëjë zyra vendore. E gjithë struktura e re mund të paraqesë, madje e ka për detyrë, sesi do të funksionojnë zyrat vendore, do të ketë manual procedurash. Kush është dakord me nenin 10?

Ilir Beqaj – Jo, nuk jam dakord, sepse nuk janë përcaktuar detyrat.

Eduard Shalsi – A ka ADISA ndërveprime me këtë?

Ilir Beqaj – Po, por me një skemë tërësisht të re. Pika kyçe e ndryshimit të skemës është që ADISA të jetë interaktive dhe me marrëveshjen e re punonjësit e ADISA-s duhet të kenë minimalisht 6 muaj punë pranë drejtorisë, të kuptojnë çdo lloj procesi dhe pastaj mund të jetë punonjës të ADISA-s.

Eduard Shalsi – Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13.

Ilir Beqaj – Te neni 13, pika 2, “Kartat dhe hartat që përbëjnë kadastrën administrative në format shkresor (letre dhe digjital) format letër dhe digjital...”

Valgent Duni – Ndoshta është çështje terminologjie që përdor ZRPP-ja, e cila quan hartën kartë dhe format shkresor quan shkresën me kokë...

Ilir Beqaj – Te pika 3 germa (c), ku themi llojin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë, truall, tokë bujqësore, kullotë, po pyjet?

(Diskutime pa mikrofon)

Në pikën 7 thuhet: “Të dhënat që përmbajnë dokumentet përdoren strikt, sipas përcaktimit të këtij ligji”. Çfarë do të thotë përdorim strikt?

Valgent Duni – Ligji vetë është strikt.

Ilir Beqaj – Ligji për atë punë është.

Eduard Shalsi – A keni gjë tjetër?

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me rekomandimet.

Neni 14.

Ilir Beqaj – Kam përshtypjen se e gjithë pjesa e nenit 14 duhet të shkojë te përkufizimet, sepse këtu ti përkufizon.

(Diskutime pa mikrofon)

Po pse zona e regjistrimit, që është bashki e zonës kadastrale, nuk është përkufizim? Pika 4 nuk është përkufizim, por pika 2 është komplet përkufizim, apo jo zonja Merlika?

(Diskutime pa mikrofon)

Po flas për pikën 2.

(Diskutime pa mikrofon)

Si të doni, por për mua pika 2 është përkufizim.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Mbajeni shënim që ta bëjmë në formë rekomandimi.

A keni gjë tjetër për nenin 14?

Ilir Beqaj – Jo, nuk kam gjë tjetër për nenin 14.

Eduard Shalsi – Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15.

Ilir Beqaj – Në pikë 5 thuhet: “Agjencia kombëtare ka për detyrë të krijojë harta kadastrale për të gjithë territorin. Harta specifike kadastrale përgatitet sipas nevojës së shtetit”. Mund të themi nevojat e institucioneve shtetërore dhe jo nevojat e shtetit. Cila është nevoja e shtetit?

(Diskutime pa mikrofon)

Unë po them saktësimin, sepse idenë e kuptoj.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Do ta lëmë nesër në orën 8...

(Mungesë regjistrimi)

Vullnet Sinaj - ...thuhet: “Kur gabimi konstatohet në hartat kadastrale drejtori i zyrës mund të urdhërojë riverifikimin në terren”. Kë urdhëron ai?

Po, mund ta bëjë vetë drejtori konstatimin në terren, jo të urdhërojë. Kë do të urdhërojë ai?!

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Ka kuptimin që ai emërtion një urdhër, për shembull, akti administrativ është urdhër.

Eduard Shalsi – Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17.

Ilir Beqaj - Nenin 17 po e nis nga fundi. Në pikën 6 fjalja e dytë është e panevojshme.

(Diskutime pa mikrofon)

Valgent Duni – Është hartuar për arsyen e precedentëve negativë, për ta vënë theksin te pavlefshmëria e gjësë, edhe pse është evidente, kemi menduar që ta shtojmë.

Artan Lame- Realisht është ajo që thotë zoti Beqaj, pra duket si parazitare, por veçanërisht deputetët që kanë qenë në terren dhe që kanë parë tipologjinë e pafundme të shpikjeve që bëjnë njerëzit, është më mirë të jetë, pavarësisht se duket si parazitare. Ai mund të thotë pse më duhet mua kjo, e kam këtu këtë, por kur e ka të shkruar se çdo gjë që është jashtë këtij formati, nuk ka vlerë, ia mbyll gojën.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë e kam te thelbi i pikës 5, besoj se me fillimin e zbatimit të këtij ligji dhe të këtij institucioni, ky informacion do të jetë dixhital, siç e kemi kërkuar. Domethënë, edhe një certifikatë lëshohet nga informacioni dixhital dhe jo detyrimisht nga një dokument ligjor origjinal.

Sot bazat e të dhënave shtetërore, me një informacion të klasifikuar dhe të certifikuar ...

(Mungesë regjistrimi)

Valgent Duni – Ka disa nene të tjera, ku veçanërisht është ecur shumë me hapin teknologjik, siç është neni i regjistrimit të detyruar. Te ky nen jemi përpjekur të marrim parasysh edhe fazën transitore deri në arritjen e dixhitalizimit. Nuk mund ta shmangim fenomenin, që një pjesë shumë e madhe e dokumentacionit që prodhohet, prodhohet mbi bazë shkresore, jo dixhitale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aktualisht, sot që po flasim...

Ilir Beqaj – Kështu siç e ke lënë ti, për sa kohë që ky ligj është i paprekur, kur një gjë gjenerohet në shërbim dixhital, nuk do të prodhojë dot certifikatë. E ke përkufizuar “lëshohet mbi bazën e një dokumenti origjinal ligjor”. Atje ku folëm për dokumentin, thamë dokument ose dixhital.

Valgent Duni – Dokumenti origjinal ligjor ekziston në çdo rast, mënyra se si administrohet, që mund të jetë edhe i dixhitalizuar, i marrë në fillim...

Ilir Beqaj – Jo, nuk ekziston në çdo rast, sepse ti ke institucione sot në botë që kur miratohet certifikata nuk është dokument, por është kod VKM-je.

Valgent Duni – Bie dakord te kjo gjë.

Ilir Beqaj – Por ti e ke përkufizuar, nuk e ke lënë dokument elektronik .

Specialist – Edhe dokumenti elektronik, është dokument ligjor, nuk më duket se është kufizues.

Ilir Beqaj – Tek dixhitalja nuk ka origjinale dhe kopje, te letra ka origjinale dhe kopje. Dokumentin ligjor e ke në rregull, origjinali ta ngushton, e lë në botë fizike, jo në botë dixhitale. Ky është mendimi im.

Artan Lame – Ta shikojmë një herë me termin origjinal.

(Diskutime pa mikrofon)

Valgent Duni – Origjinali është ai që tregon origjinën e pronësisë.

Eduard Shalsi – Ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Certifikatat e humbura”.

(Diskutime pa mikrofon)

Valgent Duni – Sot ka një parashikim për mënyrën se si zëvendësohet një certifikatë e humbur. Thjesht është synuar që të bëhet një përshkrim i kërkesës që duhet të paraqesë qytetari, pra njoftimin që duhet të bëjë në rast se e ka humbur atë certifikatë, i publicitetit që duhet të bëjë përpara se të lëshohet e reja.

Ilir Beqaj – Pse duhet të vij të deklaroj që më ka humbur ekzistuesja dhe duhet të ketë dy javë kohë për t’u njoftuar publiku, siç ndodh me pasaportat apo me divorcet? Cila është

nevoja? Për shembull, në qoftë se unë e kam marrë, e kam marrë kur kam marr shtëpi për herë të parë. Mbas 5 vjetësh po shkova në bankë, banka thotë “ik dhe rifreskoje dokumentin”, sepse nuk beson banka pas 5 vjetësh. Pavarësisht se banka nesër me...

Së dyti, në qoftë se nesër, unë si individ do të kem firmë dixhitale, nga kompjuteri i shtëpisë...

Artan Lame – Jo, që në pikën e parë ke një gabim, ndoshta mund të jem edhe unë gabim pas shpjegimit, le të ma thotë ...

Ti kur ke dokumentin e pronësisë të shtëpisë dhe ai është unik, ai nuk ka afat. Ti mund ta çosh në çdo moment, sepse është pa afat. Në qoftë se ti kryen një transaksion me shtëpinë, duhet të dorëzosh atë dokument, pra ai nuk të mbetet në shtëpi, ti nuk mund të spekulosh me atë dokument, sepse duhet ta dorëzosh.

Ilir Beqaj – Pse e dua unë atë dokument?

Artan Lame – Jo, nuk e mban dot.

Valgent Duni – Është çështja për sigurinë e tregut.

Artan Lame – Dokumenti që ti ke në shtëpi është gjithmonë i vlefshëm, sepse ti nuk mund ta kesh në shtëpi atë në qoftë se e ke shitur shtëpinë.

Ilir Beqaj – Pse dublikatën duhet ta deklaroi të humbur?

Artan Lame – Banka nuk të kërkon rinovim të certifikatës, sepse certifikatë një ke, mund ta kesh edhe të para 30 vjetëve.

Ilir Beqaj – Po mund ta kem shitur?

Artan Lame – Po e shite, duhet të dorëzosh certifikatën që të bëhet e reja.

Ilir Beqaj – Asgjësohet.

Artan Lame – Po, asgjësohet ajo, është unike.

Valgent Duni – Është e drejtë, çdo certifikatë është unike.

Ilir Beqaj – Po në qoftë se e humbas pse duhet të rri dy javë?

Artan Lame – Është një lloj lajmërimi publik, e gjeta unë dhe pash dhe lajmërimin atje dhe shkoj për t’ia çuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këndi i njoftimeve publike të bashkisë, njëkohësisht është edhe këndi i sendeve të gjetura. Jo më larg se dje ne kemi bërë një njoftim në këndin e bashkisë për një familje që nuk hap derën për të bërë skualifikimin tek Unaza, atëherë ne u detyruam që skualifikimnin ta bënim

nga jashtë, të vëmë letrën te bashkia, sepse thonë se nuk ka njeri në shtëpi. Bashkia vendos një letër ku thotë “ka dalë ky vendim skualifikimi”, dhe në atë moment ti quhesh i lajmëruar, e pe apo nuk e pe.

Ilir Beqaj – Flas për vete, jo për interesin tënd si institucion. Unë jam unë, erdha të thashë se më ka humbur dhe e dua nesër. Ti thua jo. Njofto një herë, të presim dy javë, sepse ...

Artan Lame – Po që të shmangim situatën që të notojnë me etern dy tituj, edhe e vjetra, edhe e reja.

Eduard Shalsi – Jam shumë i qartë, këtë debat nuk mund ta shndërrojmë në trajnim konceptesh.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 26. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 30.

Vullnet Sinaj – Neni 30 “Regjistrimi fillestar”. Do t’i japim një afat, të mbarojë ky regjistrim, fillestar, sepse ka që në ’94-ën që nuk mbaron. Është gati njësoj si ligji këtu, sepse i lexova të dyja ligjet, si neni 24 i ligjit të mëparshëm, keni hequr ndonjë nen, por këtij duhet t’i vendosni një afat që të përfundojë.

Artan Lame – Është e drejtë vërejtja juaj, unë për të qenë në rregull me ju edhe mund ta mbyll afatin, por praktikisht deri më sot është treguar se janë shkelur edhe afate që kanë qenë ligjore për gjërat, pra po të mos bëhej pengohej një proces tjetër, dhe jo më afate të tilla.

Atëherë, kjo është harta e zonave me dhe pa regjistrim fillestar, pra me të verdhë janë të bërat, kurse me të kuqe janë të pabërat. Duket sikur ka mbaruar, por më pas vijmë te zonat që kanë nevojë për përditësim. Pra, më i rëndësishëm se sa ky është përditësimi dhe këtu të jep mirë keq. Kafja e errët janë keq. Po të shikosh keq janë ato ku lëviz e gjithë Shqipëria, pra Vlorë, Fier, Kavajë, Tiranë, Krujë, Lezhë, Shkodër dhe Korçë. Domethënë, më shumë se sa kjo, sepse këtu ka mbetur Tropoja...

Vullnet Sinaj – Mendon që është më mirë ta lëmë pa afat?

Artan Lame – E vendosim, por nuk do të zbatohet.

Vullnet Sinaj – Në rregull.

Eduard Shalsi – Neni 30. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37.

Vullnet Sinaj – Në nenin 37, pika 7, germa “a” thuhet: “Kur poseduesi i ndërtimit që ligjësohet ka një titull më të hershëm mbi tokën, që nuk buron nga legalizimi, zbatohen dispozitat e këtij neni, duke i kërkuar gjykatës të vendosë për prioritetin e titullit të poseduesit”, më duket e tepërt, që të vendosë gjykata për prioritetin e titullit të poseduesit.

Valgent Duni – Realisht çështjet e mbivendosjeve, edhe sot e kësaj dite, janë objekt shqyrtimi gjyqësor në çdo rast, sepse kanë të bëjnë me vlefshmërinë e njërit titull apo të tjetrit.

Vullnet Sinaj – Kjo është vetëm për regjistrimin paraprak.

Specialist – Përveç kësaj, ne kemi synuar që përtej efekteve të regjistrimit të zgjidhim edhe çështjen e pronës në themel. Për këtë arsye kemi menduar që të japim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj - Ka shumë raste të tjera, ku thuhet: bëhet regjistrimi dhe ka një radhë dhe e regjistron ky i pari, të tjerët shkojnë në gjykatë dhe më pas vendos gjykata, por jo të vendosi se kush e ka prioritetin për regjistrim në hipotekë.

Valgent Duni – Te dispozitat e mësipërme tregohet se cila është radha e preferimit, radha e prioriteteve. Megjithatë, në momentin kur ka një ndërtim pa leje mbi të dhe duhet rregulluar lidhja e ndërtimit pa leje me tokën, për të zgjidhur mbivendosjen, për të lidhur ndërtimin pa leje me tokën, i drejtohem gjykatës në mënyrë që ajo të nxjerrë se cili titull vlen dhe cili nuk vlen, që unë ta di se kë duhet të kompensoj më pas. ALUIZNI duhet të kompensojë pronarin e tokës dhe duhet të dijë se cili prej këtyre të dyve duhet t’ia nënshtroj kompensimit.

Vullnet Sinaj – Më fal, por ti ke vendosur disa rregulla, i ke rregullat e regjistrimit se kush fiton më parë për të regjistruar. Pse në këtë rast duhet të vendos gjykata?

Valgent Duni – Në çdo rast duhet të vendosë gjykata. Edhe më sipër del që zgjidhja e mbivendosjes është objekti i shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht se kë regjistroj unë nga titujt.

Eduard Shalsi – A jeni dakord me nenin 37?

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 39. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 42. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 43. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 44. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 45. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 46. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 47. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 48.

Urdhëroni!

Eglantina Gjermani – Në nenin 48, pas paragrafit të parë, të shtohen paragrafët me përmbajtjen që vijon, të cilët kemi treguar edhe ALUIZNI-t, por gjithsesi po i lexoj.

Eduard Shalsi - Nuk ka nevojë sepse i kemi lexuar.

A jemi në rregull me këtë?

Kush është dakord me nenin 48 bashkë me citimet e zonjës Gjermani? Kundër? abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 50. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 51. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 52. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 53.

Eglantina Gjermani – Edhe këtu duhet të shtohet një nen tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Regjistrimi i dëshmisë së trashëgimisë, neni 53/1 “Dëshmia e trashëgimisë ligjore testamentare, redaktuar nga noteri në bazë të ligjit, regjistrohet në kadastrë. Zyra e kadastrës evidenton në kartelën përkatëse të pasurisë pjesët e pasurisë së paluajtshme të trashëgimlënësit, që janë në bashkëpronësi me bashkëshortin/bashkëshorten, pasijetues/pasijetuesen mbi bazën e certifikatës familjare, martesore ose kontratën e regjimit pasuror martesor në kohën e fitimit të pronësisë”.

Eduard Shalsi – Dakord.

Kush është dakord me shtesën e zonjës Gjermani?

(Diskutime pa mikrofon)

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 54. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 55. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 56. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 57. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 58. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 59. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 60. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 61. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 62. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 63. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 64.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Zoti kryetar, ne kemi 2-3 kadastra të tjera dhe ndoshta duhet të shikojmë si mund të bashkërendojmë, sepse ne kemi kadastër pyjesh me ligj, kemi kadastër mineraresh me ligj. Tani ky i përmbledh të gjitha. Tani, do të rrimë në kadastër prone, apo do të shkojmë në kadastër shumëqëllimshme, sepse më duket se Ministria e Bujqësisë ka kadastër vreshtash?! Pra, kemi disa kadastra që i kemi me bazë ligjore.

(Diskutime pa mikrofon)

Valgent Duni – Nisur nga ideja e të drejtës civile, që çdo gjë që është e lidhur me tokën është pjesë e pasurisë së paluajtshme, është menduar që të pasurohet në vazhdimësi edhe me këto të dhëna. Sidoqoftë, harta vetë, regjistri që do të administrojë agjencia, të pasurohet gradualisht edhe më këto të dhëna.

Ilir Beqaj – Po të vijmë te pika 5 “Pusi i naftës”, çfarë keni parasysh këtu, kullën që shpon apo rezervën poshtë?

Valgent Duni – Faktikisht e gjithë infrastruktura, me gjithë të dhënat për burimin...

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Këtu hyn një shkencë shumë e madhe, që do të thotë se çfarë quhet pronë sipas legjislacionit shqiptar dhe sipas legjislacionit ndërkombëtar. Kjo do të thotë se, në qoftë se unë jam pronar i kësaj copëze toke, jam pronar edhe i qiellit sipër deri në qendër të tokës...

Ilir Beqaj – Në Shqipëri është deri në 60 cm, më duket...

Artan Lame – Në këtë moment regjistri i pasurive të paluajtshme të jetë deri te 60 cm.

Ilir Beqaj – Pjesa poshtë është publike, është pasuri e përbashkët ajo.

Artan Lame – Pjesa poshtë ka një tjetër mënyrë procedimi.

Ilir Beqaj – Minierës se Bulqizës çfarë do t'i regjistrosh, kur ajo e ka pusin 800 metra?

Artan Lame – Unë të regjistroj linjën, hyrjen etj...

Ilir Beqaj – Do një lloj saktësimi se do të ngatërrohemi këtu te miniera.

Artan Lame – Ndërsa te bujqësia hyn e gjitha, sepse je në nivelin e rrënjëve.

Valgent Duni – Të mos ngatërrojmë pasurinë me pronarin. Ajo pa diskutim që është pronë publike. Burimi minerar është pronë e shtetit shqiptar. Thjesht fakti që regjistrohet, evidentohet...

Ilir Beqaj – Edhe spitali publik është, por e regjistron.

Valgent Duni – Evidentohet si pasuri publike...

Ilir Beqaj – Edhe këtu kam një pyetje: shtylla e tensionit të lartë do të regjistrohet te ju? Antenat e celularëve do të regjistrohen te ju?

Valgent Duni – Në një moment të dytë përfytyroj që po.

Ilir Beqaj – A e parashikon sot ligji, se zbatimi mund të shkojë 10 vjet?

Valgent Duni – Duke qenë se send i paluajtshtëm është gjithçka sipas Kodit Civil, çdo gjë që regjistrohet te ky produkt do t'u përmbahet kriterëve që ka Kodi, i cili thotë se të gjitha ato, që janë të lidhura pazgjishmërisht me tokën, janë të regjistrueshme. Nuk mund të shkëputet nga toka pa i hequr funksionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Kjo që thua është e rëndësishme, por do një moment reflektimi. Ky problem na doli te ligji i legalizimeve. Ligji i vitit 2006 parashikonte se çfarë quanim ndërtim, pra thjesht të ketë mbaruar beton arme, të jetë i mbuluar... Ne bëmë këtë logjikë: ndërtim pa leje është çdo ndërtim, për të cilin nevojitet një leje sipas legjislacionit në fuqi. Donin t'i legalizonin antenat dhe nuk hynin dot. Kështu që kjo meriton një moment reflektimi dhe na i jep mundësinë ta bëjmë të paktën nesër, ose pasnesër.

(Zoti Shalsi flet pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Ka një herë një ankimim brenda, pastaj shkohet në gjykatë.

Artan Lame – Një nga risitë e agjencisë është kjo: ne zgjodhëm skemë turke...

Ilir Beqaj – Mos ka ndonjë kufizim te ligjet shqiptare? Mos ke detyrim të shkosh në dy nivele me një ligj kuadër? Nuk e di për shembull, Kodi i Procedurës Administrative...

Artan Lame – Nuk ka, sepse e verifikuam kur bëmë zgjedhjen. Bordi i apelimit i agjencisë këtë gjë bën. Ai është pak a shumë i pavarur nga agjencia. Ti ankohesh te bordi, në qoftë se nuk je dakord me vendimmarrjen e agjencisë.

Ilir Beqaj – Me sa di unë, Kodi i Procedurës Administrative, nga eksperiencia ime të detyron dhe Kodi është mbi të gjitha ligjet, pra që të bësh një ankimim tek organi që e ka nxjerrë, pastaj shkon në gjykatë.

Artan Lame – Patjetër. Këtë po them Pra, i pari është drejtori, të cilit i thua që nuk je dakord me këtë vendim.

Ilir Beqaj – Nuk e ke këtu. Pika 3 e nenit 66 nuk e ka këtë, por thotë shkon në gjykatë.

Valgent Duni – Kundër sanksioneve që merren ndaj punonjësve mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë. Edhe Kodi ia njeh mundësinë ligjit të posaçëm që ta parashikojë drejtpërdrejt ankimin në gjykatë. Dua të them se nuk është një institut i panjohur. Për më tepër, edhe për çështjen e niveleve të ankimit...

Ilir Beqaj – Ma gjej nenin e Kodit të Procedurës që e njeh...

Valgent Duni – Nuk e kam.

Ilir Beqaj – Ma sill nesër.

Valgent Duni – Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Ky është hapi i parë. Ndoshta duhet të themi që krijimi për herë të parë i agjencisë bëhet...

Valgent Duni – Është nga ana administrative. Nga ana administrative, infrastruktura dhe punonjësit e këtyre tri agjencive bashkohen te njëra. Kompetencat janë tjetër gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Ndërsa unë po them “krijimi për herë të parë i agjencisë... ndërtohet si bashkimi i këtyre të triave”. Pra, i pari, sepse pastaj mund të vijnë edhe institucione të tjera.

Ilir Beqaj – Do të vijë një amendim pastaj.

Artan Lame – Jo, nuk ka nevojë.

Ilir Beqaj – Po si do të vijë tek ty një institucion tjetër?

Artan Lame – Duke thënë krijimi për herë të parë me këto të tria. Pastaj do të thuash edhe si do të bëhen ato të tjerat, me VKM.

Ilir Beqaj – Si do të bëhet me VKM? Ai institucioni tjetër bazohet në një ligj të caktuar. Do të amendojmë atë ligj që ta sjellim tek ju. Nuk do të vijë vetë. S’ bëhet me VKM.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – A ka ndonjë propozim?

Neni 69? Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 70.

Ilir Beqaj – Te pika 2 e nenit 70, pse duhet të të shërbejnë pa asnjë tarifë, kur ti koston e nxjerr me tarifa mbi qytetarët? Pse ke këtë luks të të shërbejnë të tjerë? Përderisa ti vetë nxjerr tarifa për të mbuluar shpenzimet, pse duhet të tjerët të të shërbejnë pa tarifa.....

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Këtu hyjmë në një diskutim të madh pastaj që një institucion që nxjerr 10 mijë letra në vit, duhet të vërë tarifa për to?

Ilir Beqaj – Po, patjetër.

Artan Lame – Patjetër, ne po i shërbejmë sot Ministrisë së Drejtësisë...

Ilir Beqaj – Patjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Valgent Duni – Në bazë të ligjit tjetër për proceset kalimtare për institucionet e tjera shtetërore dhe për njësitë vendore janë parashikuar tarifa të reduktuara. Në këtë pikëpamje është menduar....

Eduard Shalsi – Neni 71. Pro? Kundër? Abstenim?

(Diskutime pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Te neni 71, dispozitat kalimtare, propozojmë të shtohet një nen më këtë përmbajtje: “Nuk aplikohet tarifë për regjistrimin, korrigjimin ose përditësimin e të dhënave kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.”.

Valgent Duni – Bëhet fjalë për të gjitha regjistrimet e gabuara që janë bërë më parë, ku është shënuar vetëm njëri bashkëshort.

Eglantina Gjermani – Po përditësohen të dhënat me të dy bashkëshortët.

Ilir Beqaj – Te pika 1 e nenit 71 në fund fare thoni “zyrës së Kryeministri”, atje thatë “kabineti i Kryeministrit”. Jini koherentë.

Artan Lame – Institucionalisht është ende e paqartë edhe për ata vetë nga teknologjia. Pra, në shtetin shqiptar përdoret termi “Republika e Shqipërisë, Kryeministria”. Nuk ekziston asnjë term “kryeministria”, por përdoret.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ju duhet të jeni koherentë, ose përdorni atë, ose këtë.

Vullnet Sinaj – Meqenëse bëme korrigjim fjalësh, te pika 4 “agjencia e legalizimit, urbanizmit dhe integritetit të zonave” pra jo të objekteve.

Eduard Shalsi – Neni 71. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 72. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 73. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 74.

Vullnet Sinaj – Duhet të kini kujdes, sepse më duket sikur bie në kundërshtim me nenin 198 të Kodit Civil, i cili thotë: “Ministria e Drejtësisë administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasurinë e paluajtshme. Kushtet, mënyra e regjistrimit dhe organizmit, si dhe çdo procedurë që ka lidhje me këtë veprimtari rregullohet me ligj të veçantë”. Në këtë rast ju thoni “KSHA-ja administron bazën e të dhënave shtetërore mbi pasurinë e paluajtshme. Këtu përfshihen edhe të dhënat që administrohen sipas ligjit. Përfundimi i proceseve kalimtare të pronësisë, rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Këtu biem në kundërshtim me Kodin Civil, ose do të futet këtu edhe ministrja e Drejtësisë.

Valgent Duni – Një variant i përditësuar i draftit, duke pasur parasysh këtë vërejtje...

Eduard Shalsi – Ai i rekomandimeve?

Valgent Duni – Po.

Eduard Shalsi – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Pro?Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 75. Pro? Kundër? Abstenim?

Ilir Beqaj – Mendoj që ose te neni 75, ose te neni 76/2 nuk mund t’u lëmë pa një afat për nxjerrjen e akteve, sepse i gjithë sherri i studentëve është mosnxjerrja e akteve për tre vjet.

Eduard Shalsi – Sa është propozimi? Për sa kohë?

Ilir Beqaj – Për sa kohë u duhet atyre, sepse nuk e di sa akte janë. E lëmë me muaj. Nuk e lëmë brenda vitit.

Eduard Shalsi – Brenda 12 muajve. Kush është dakord me propozimin e zotit Beqaj? Dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet, pra 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 75. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 76. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ilir Beqaj – Më fal, kryetar, amendimi që propozova unë shkon më shumë te pika 2 e nenit 76 se te neni 75.

Eduard Shalsi – Po.

Neni 77. Pro? Kundër? Abstenim?

Ilir Beqaj – Jo, neni 77. Mos është shumë afër 1 shkurti, sepse u vonua miratimi? Llogarit sa i bie data. Kur do të kalojë në seancë? Duhet edhe 10 ditë të dekretohet dhe 15 ditë do Fletorja Zyrtare, 10 ditë të mbeten për të filluar punë. Mos do ta shtysh?

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Është e qartë.

Neni 77. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ligjin do ta çojmë bashkë me rekomandimet që kemi diskutuar për nene të caktuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 28 i ligjit për kadastrën ka një definicion. Pastaj, nëse do të vijohet me një VKM të posaçme për zhvillimin më të detajuar të arkitekturës së sistemit softuer dhe harduer që duhet të ndërtohet brenda kësaj agjencie, te neni 28 “garantimi i aksesit mbi ekstraktet” direkt pas pikës 2 të saj të shtohet: “Agjencia shtetërore e kadastrës siguron kushtet për krijimin,

regjistrimin, administrimin dhe funksionimin e të dhënave dixhitale të pasurive të paluajtshme në sistemin e brendshëm të organizmit dhe të ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”. Kjo është ajo për të cilën kishim rënë dakord bashkë. Pro? Kundër?

Ilir Beqaj – Kundër. Ndërveprimi ka ligj tjetër në Shqipëri.

Eduard Shalsi – Dakord jemi.

Shënoni votën kundër të Beqjas.

(Diskutime pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 19:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi nen për nen i projektligjit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Teuta Vodo - Zëvendësministre e Drejtësisë

Artan Lame - Drejtor i Përgjithshëm i ALUZINI-t

Edvin Kukunja - Këshilltar i Ministres së Drejtësisë

Vangelt Duni – përfaqësues i ALUZINI-t

Ermira Gjeçi - Zëvendësministre e Bujqësisë

Majlinda Bozgo - Përgjegjëse në Sekretariatit Teknik në Komisionin Qeveritar të Tokës/Ministria e Bujqësisë

Lorena Goxhobelli - Këshilltare e Ministrit

Eduard Shalsi – Kalojmë te ligji tjetër "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Në parim e kemi miratuar.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 27. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 28. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 29. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 30. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 31. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 32. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 33. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 34. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 35. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 36. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 37. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 38. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 39. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 40. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 41. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 42. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 43. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 44. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 45. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 46. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 47. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 48. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 49. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 50. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 51. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 52. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 53. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 54. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 55. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 56. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 57. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 52. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 58. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 59. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 60. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 61. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 62. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 63. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 64. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 65. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 66. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 67. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 68. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 69. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 70. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 71. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 72. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 73.

Ilir Beqaj – Te pika 1 e nenit 73 nuk ka shtojcë pas titullit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na i sillni. “Aktet ligjore të listuara në shtojcë, bashkëlidhur”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo duhet të quhet shtojca 1.

Eduard Shalsi – Neni 73. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 74 “Hyrja na fuqi”. Thotë më 1 shkurt.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet, bashkë me sugjerimet që do t’ia transmetojmë Komisionit të Ligjeve.

Falënderoj deputetët për kontributet, sidomos zotit Sinaj dhe zotit Beqaj, por jo vetëm!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA